



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25 regjistër (JR)
Datë 20.05.2019

Nr. 35 i vendimit
Datë 15.12.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.12.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 25 (JR), datë 20.05.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 113, datë 08.03.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet A, Ç, D dhe F të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi

ankimin, sipas shkaqeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 113, datë 08.03.2019, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe, për rrjedhojë, ai gëzonte statusin e magjistratit¹. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, z. Arqilea Koça iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë³, deklaratën për kontrollin e figurës⁴ dhe formularin e vetëvlerësimit profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin se formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe se për subjektin e rivlerësimit Arqilea Koça nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për

¹Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe prokurori, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaramit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklaramta e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 20.10.2016.

⁵ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 24.04.2018, të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme për “Vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, formulari i vetëvlerësimit profesional është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 26.01.2017.

kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Për rrjedhojë, DSIK-ja konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

5. Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm⁶ dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Grupi i Punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arqilea Koça, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 113, datë 08.03.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 113, datë 08.03.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arqilea Koça, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016⁷, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1. *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arqilea Koça, rezultoi se: (i) ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kontrollin e pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhim, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

8.2. *Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni ka arritur në përfundimin se gjatë hetimit administrativ, nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime lidhur me pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit.*

8.3. *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni arrin në përfundimin se pasi është kryer rivlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça është i aftë profesionalisht.*

8.4. *Në lidhje me vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni arrin në përfundimin se me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 113, datë 08.03.2019, me pretendimin se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe rezultat sa i cenimit dhe shkeljes së normave dhe rregullave ligjore për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, aq edhe i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike

⁶ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 24.04.2018.

⁷ Trupi gjykues konstatoi se, ndonëse është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, vendimi i Komisionit rezulton të jetë bazuar në dispozitat ligjore që parashikojnë konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

të rezultuara dhe vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë, si dhe i interpretimit të gabuar të koncepteve ligjore me të cilat është operuar. Sipas subjektit të rivlerësimit, interpretimi dhe vlerësimi nga Komisioni i konstatimeve të tij është tej synimeve dhe qëllimeve të kuadrit ligjor e kushtetues dhe, në përgjithësi, jo në frymën e reformës në drejtësi.

10. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se referuar nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) duhet vendosur shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi debati gjyqësor, sipas tij, është i nevojshëm për të vlerësuar pretendimet e tij, se vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është i bazuar në shkelje të rënda procedurale, në gjendjen faktike të konstatuar gabim ose në mënyrë jo të plotë nga Komisioni, sikurse dhe në vlerësim të gabuar të fakteve dhe në interpretim të gabuar të ligjit.
11. Subjekti i rivlerësimit ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore, të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provave të reja. Ai pretendoi se këto prova janë të tilla dhe nuk janë paraqitur më parë për shkak se ose nuk i është kaluar barra e provës në mënyrë të qartë, ose argumentojnë qëndrimet e tij dhe kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit, të cilat janë evidentuar për herë të parë në vendimin e tij. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *gjykimin e çështjes në seancë publike;*
 - *ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 113, datë 08.03.2019;*
 - *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.*
12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*12.1. Përfundimi i arritur nga Komisioni lidhur me pasuritë e përfituara nga kontrata e shkëmbimit me shoqërinë {***} ShPK, është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vlerësim të rrethanave në të cilat janë kryer deklaratimet ndër vite, mosdeklarimi i këtyre pasurive në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë (në vijim referuar “DIPPV”) të viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 nuk mund të marrë vlerën e pasaktësisë me pasojë deklarim të pamjaftueshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.*

*12.2. Konkluzioni i arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë “tokë arë” me sipërfaqe 830 m², e cila sipas Komisionit ka shërbyer si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shkëmbimi me shoqërinë “{***}” ShPK, është i pabazuar dhe rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor.*

12.3. Konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me huapërdorjen e dy prej apartamenteve të subjektit të rivlerësimit nga personat S. Sh. dhe M. G., si dhe lidhur me huapërdorjen e një vendi parkimi nga personi R. S., janë konkluzione të padrejta, të pabazuara dhe rrjedhojë e një procesi në cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

12.4. Konstatimi i Komisionit në rubrikën “Vlerësimi tërësor i çështjes”, në pjesën arsyetuese të vendimit, se ka thënie kontradiktore në lidhje me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit të dy prej pasurive në pronësi të tij, është i pabazuar dhe rrjedhojë e një vlerësimi subjektiv nga ana e

Komisionit, për pasojë edhe vendimmarrja e Komisionit e bazuar në këtë konstatim është e gabuar.

12.5. *Konkluzioni i arritur nga Komisioni, sipas të cilit si pasojë e ndërtimit në mënyrë të paligjshme dhe mosdeklarimit në vitin 2003 të objektit me sipërfaqe 36 m² të ndërtuar në vitin 1996 në {***}, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, është i gabuar.*

12.6. *Konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë të pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sip. 92,45 m², ZK {***}, vol. {***}, f. {***} në {***}, Sarandë në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, pranë ILDKPKI-së dhe në deklaratën e pasurisë (vetting), është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe rrjedhojë e zbatimit të standardeve të dyfishta nga ana e Komisionit.*

12.7. *Konkluzioni i Komisionit për mosdeklarim në deklaratën për herë të parë në vitin 2003 të të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2001, nga shitja e pasurisë së paluajtshme të privatizuar në Korçë, në shumën prej 1.250.000 lekësh, dhe konkluzioni për deklarim të rremë të kësaj të ardhure në deklaratën e pasurisë (vetting) janë të gabuara, të pabazuara në ligj dhe në prova dhe mbi të gjitha konkluzione të arritura në mungesë të veprimeve hetimore në drejtim të sa më sipër, si dhe rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor.*

12.8. *Konkluzioni i Komisionit lidhur me përfitimin nga subjekti i rivlerësimit të kredisë me kushte lehtësuese në shumën e 5.000.000 lekëve në vitin 2000, më shumë se një herë dhe në kundërshtim me ligjin, është konkluzion i gabuar, i pambështetur në ligj dhe në prova dhe rrjedhojë e një procesi vendimmarrjeje në cenim të parimit të objektivitetit dhe të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.*

12.9. *Konkluzionet e Komisionit lidhur me përfitimin e pasurisë së paluajtshme në Korçë me kontratën e privatizimit të datës 05.07.2000, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” dhe me ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, si dhe “duke përdorur funksionin e tij si prokuror” janë të pabazuara dhe të padrejta. Të pabazuara janë edhe aludimet e Komisionit për sjellje joetike në pranimin e privatizimit të kësaj pasurie në vitin 2000.*

13. *Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

13.1. *Vendimi i Komisionit lidhur me procesin e rivlerësimit është marrë në shkelje të (i) parimit të objektivitetit në gjykim, (ii) parimit të proporcionalitetit, (iii) në zbatim të gabuar të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe (iv) interpretim të gabuar të konceptit të cenimit të besimit të publikut tek drejtësia.*

13.2. *Sjellja e trupës gjyquese të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme duke qenë se hetimi kryesisht në lidhje me kriterin e*

pasurisë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit janë kryer nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Arqilea Koça, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁸ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 113, datë 08.03.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja dhe kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, arriti në përfundimin që, edhe pse aktet e dorëzuara në cilësinë e provave të reja përmbushin kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në

⁸ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 113, datë 08.03.2019, për rivlerësimin e subjektit Arqilea Koça, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 09.04.2019, konfirmuar ky fakt, sipas lajmërim-marrjes, më datë 13.04.2019, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 26.04.2019, protokolluar në Komision me nr. {***}, në të njëjtën datë, që rezultoi të jetë dita e 13-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Komision, hetimi i mëtejshëm nga ana e Kolegjit dhe marrja e këtyre akteve në cilësinë e provave të reja nuk u gjetën të nevojshëm dhe, për rrjedhojë, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, u refuzua. Kolegji arriti në përfundimin se, në referencë të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, debati gjyqësor nuk ishte i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendim nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. *Lidhur me pasuritë e përfituara nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të kontratës së lidhur me shoqërinë {***} ShPK për shkëmbimin e tokës me sipërfaqe ndërtimore, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i arritur nga Komisioni është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
19. *Komisioni, në lidhje me kontrollin dhe vlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme në kuadër të procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim: [...] Mosdeklarimi i posedimit/përdorimit real të tetë pasurive në deklaratën periodike për vitin 2009 nga ana e subjektit Koça, ka vështirësuar kontrollin e pasurive sipas parashikimit të kësaj dispozite ligjore, konkretisht: evidentimin e faktit se si dhe nga kush janë përdorur këto pasuri për disa vite, si dhe nëse janë përfitur të ardhura nga dhënia e tyre personave të tretë. Për të gjitha sa është arsyetuar më sipër, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i të drejtave reale të pronësisë në deklarin periodik për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria "{***}" ShPK, është pasaktësi me pasojë deklarim të pamjaftueshëm të pasurive nga ana e subjektit dhe duhet të merret në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, si provë me të njëjtën rëndësi sa dhe deklaratimet e pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën vetting.*
20. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e Komisionit, me pretendimin se në vlerësim të rrethanave në të cilat janë kryer deklaratimet ndër vite, mosdeklarimi i këtyre pasurive në DIPPV-të e viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 nuk mund të marrë vlerën e pasaktësisë me pasojë deklarim të pamjaftueshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të këtij shkakut të ankimit të tij, subjekti parashtroi se:*
 - 20.1. *Të gjitha kontratat e lidhura me shoqërinë sipërmarrëse në kuadër të marrëdhënies juridike të sipërcituar, si dhe kontratat e lidhura me persona të tretë, lidhur me shitjen e apartamenteve të përfituara si pasojë e marrëdhënies me shoqërinë {***} ShPK, janë deklaruar rregullisht dhe në mënyrë korrekte në deklaratimet periodike sipas legjislacionit të kohës në fuqi.*
 - 20.2. *Deklarimi i këtyre pasurive është kryer në vitin 2014, në momentin e fitimit të titullit të pronësisë mbi to dhe se, deri në atë moment, është gjykuar se në kërkesat e formularit të deklaratimit periodik, detyrimi për të pasqyruar pasuritë e paluajtshme që nuk janë regjistruar në regjistrat publikë lidhet me pasuritë e ndërtuara në mënyrë informale.*
 - 20.3. *Interpretimi i Komisionit se pasaktësitë në deklarin periodik "mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën vetting", është një interpretim i gabuar dhe i pabazuar në ligj. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasaktësia në deklarin periodik mund të shërbejë si provë vetëm për të provuar saktësinë dhe plotshmërinë e pasurive të deklaruara në deklaratën vetting.*

20.4. Hetimi administrativ provoi që kjo “pasaktësi” nuk ka ndikuar në krijimin e ndonjë pasurie më të madhe nga sa mund të justifikohet ose që nuk është deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën e pasurisë *vetting*.

20.5. Komisioni ka mbajtur standarde të dyfishta në trajtimin e rasteve të ngjashme lidhur me subjekte të tjera të rivlerësimit.

- 21.** Në analizë të këtij shkaku ankimi, referuar dhe arsyetimit të Komisionit në vendimin e tij lidhur me pasuritë e paluajtshme të përfituara nga marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive të sipërpërmendura në deklaramin e tij para ILDKPKI-së në vitin 2009, dhe në vitet në vijim deri në vitin 2014, si pasojë e mosdeklarimit të këtyre pasurive të paluajtshme në momentin e marrjes në dorëzim nga shoqëria “{***}” ShPK dhe këtë pasaktësi në deklaramin vjetor e ka vlerësuar si deklaram të pamjaftueshëm duke i dhënë të njëjtën vlerë me deklaramin e pamjaftueshëm të këtyre pasurive të paluajtshme në deklaratën e pasurisë (*vetting*). Për rrjedhojë, në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku të ankimit të subjektit dhe njëkohësisht kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit lidhur me vlerësimin e këtyre pasurive të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi të nevojshme të shqyrtojë deklaramet periodike të subjektit të rivlerësimit përpara ILDKPKI-së lidhur me krijimin e këtyre pasurive të paluajtshme të fituara nga marrëdhënia e shkëmbimit të tokës me sipërfaqe ndërtimore me shoqërinë “{***}” ShPK.
- 22.** Për efekt të sa më sipër, trupi gjykues mori në analizë kuadrin ligjor lidhur me detyrimin e subjekteve për deklaram të pasurisë dhe interesave privatë, nga ku konstatoi se, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaramte pranë organit kompetent, ndër të tjera, pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to. Në zbatim të nenit 15, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, interesat privatë të cilët duheshin deklaramur periodikisht ishin pasuritë, detyrimet financiare, si dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003. Në përputhje me parashikimet e nenit 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, në deklaramin periodik subjektet deklaramuese japin vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat privatë të deklaramur më parë, interesat e lindur gjatë vitit që deklaramohet dhe çdo të ardhur të fituar gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarami.
- 23.** Në kuadër të vlerësimit të përmbushjes së detyrimit për deklaram sipas kuadrit të mësipërm ligjor, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit mbi deklaramet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi faktet dhe rrethanat si më poshtë.
- a) Subjekti i rivlerësimit në “deklaratën për herë të parë” (viti 2003), në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, ka deklaramur si pasuri të akumuluar (në pronësi të tij) deri në momentin e deklaramit, pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë” me sip. 830 m², me vendndodhje në {***} ({***}), Tiranë, vërtetuar ky fakt edhe nga verifikimi i të dhënave të administruara nga ZVRPP Tiranë gjatë hetimit administrativ në Komision.
- b) Në datën 16.09.2005, subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë lidhur kontratën e shkëmbimit (me kusht) nr. {***} rep., nr. {***} kol., para noteres V. S., me objekt shkëmbimin prej subjektit të rivlerësimit të pronësisë së tokës arë me sip. 830 m², me kushtin që shoqëria “{***}” ShPK, pas ndërtimit të një godine shumëkatëshe mbi këtë truall, t’i kalonte në pronësi subjektit të rivlerësimit 26% të sipërfaqes së ndërtimit. Nga shqyrtimi i kësaj kontrate të lidhur mes palëve, u konstatua se në nenin 10 të saj, me titull “Realizimi i

shkëmbimit”, parashikohej: [...] *Pronësia e sipërfaqes së tokës kalon nga pala e parë te pala e dytë, duke ruajtur pala e parë pronësinë në 26% të sipërfaqes së tokës. Pronësia e 26% të ndërtesës kalon nga pala e dytë te pala e parë. Kalimi i pronësisë së sendeve të përmendura në këtë pikë do të bëhet me akt noterial dhe do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme [...].* Kjo kontratë ka qenë efektive që nga data e nënshkrimit të saj nga palët, por në zbatim të parashikimit të nenit 5.2 të saj, ekzekutimi i kontratës do të fillonte 1 muaj pas zbardhjes së lejes së ndërtimit⁹.

c) Në DIPPV-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar në rubrikën përkatëse, marrëdhënien juridike të krijuar me shoqërinë “{***}” ShPK, si pasojë e kontratës së shkëmbimit si më sipër cituar, duke evidentuar faktin që pasuria e tij e paluajtshme e llojit “tokë arë” i është dhënë shoqërisë sipërmarrëse për të ndërtuar një objekt shumëkatësh dhe se, nga kjo marrëdhënie shkëmbimi, subjekti i rivlerësimit do të përfitonte 26% të sipërfaqes ndërtimore të objektit. Trupi gjykues vëren se me këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit, referuar parashikimeve ligjore të cituara më sipër, ka përmbushur detyrimin e tij ligjor për të deklaruar kufizimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme “tokë arë” me sip. 830 m², si dhe për të deklaruar shoqërinë “{***}” ShPK, me të cilën i kishte lindur tashmë një lidhje interesi nga kjo marrëdhënie juridike, duke e trajtuar atë si person të lidhur, në kuptim të parashikimeve të neneve 3, pika 11 dhe 5, shkronja “b” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Me këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur në të njëjtën kohë edhe detyrimin e tij ligjor për të deklaruar faktin se ai kishte një person të lidhur (shoqërinë “{***}” SHPK), në përputhje me parashikimet e nenit 21, paragrafi i dytë i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, edhe pse ky deklaram nuk është dhënë në rubrikën përkatëse, në faqen 8 të formularit.

ç) Sipas kontratës noteriale “Shitblerje prone, pasurie të paluajtshme apartament banimi (me rezervë)” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.03.2009, para noteres V. S., subjekti i rivlerësimit ka shitur me rezervë sendin e paluajtshëm “apartament banimi” 1-5, me sipërfaqe totale ndërtimore 105 m², të cilën e zotëronte në bazë të “Aneks kontratës së sipërmarrjes”, me nr. rep. {***} dhe kol. {***}, datë 20.06.2007¹⁰, ku pala shitëse është në rolin e pronares së truallit mbi të cilin është ndërtuar godina e banimit dhe e shërbimeve 4-5-6-7 kate. Sipas parashikimeve të kësaj kontrate, në nenin 3 të saj, çmimi i shitjes së apartamentit është përcaktuar 5.500.000 lekë, i cili do të likuidohet: *Kësti i parë prej 5.000.000 lekësh është likuiduar jashtë kësaj zyre [...]. Këstin e dytë prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh pala blerëse do e likuidojë me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit. Akti përfundimtar i shitblerjes së pronës sipas ligjit do të kryhet kur të kryhet regjistrimi përfundimtar i pronës objekt kontrate, sipas ligjit.* Më tej, në kontratë, në nenin 4 të saj, përcaktohej se akti përfundimtar i shitblerjes së pronës do të kryhej kur të bëhej i gjithë regjistrimi i objektit në ZVRPP Tiranë.

d) Në DIPPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”: *Shitje apartamenti (kontratë paraprake, me*

⁹ Shoqëria “{***}” ShPK është pajisur nga Komuna {***} me lejen e ndërtimit nr. {***}, datë 07.11.2005, për ndërtimin e një godine banimi dhe shërbimesh 4-5-7 kate mbi tokë dhe 1+1/2 kate nëntokë në {***}, leje e cila është zbardhur nga KRRT e Komunës {***} me nr. {***} prot., datë 28.12.2005.

¹⁰ Referuar “Aneks Kontratës së Sipërmarrjes” me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 20.06.2007, para noteres V. S., sipërfaqja ndërtimore që përfitonte subjekti i rivlerësimit nga lidhja e kontratës së shkëmbimit me shoqërinë “{***}” ShPK është përcaktuar dhe ndarë mes palëve, sipas parashikimeve konkrete në këtë akt, ku ndër të tjera,

rezervë) sip. 105 m², komuna {***}. Vlera e shitjes 5.500.000 lekë (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, nga të cilat janë arkëtuar 5.000.000 (pesë milionë) lekë. Pjesa tjetër do të arkëtohet me bërjen e kontratës përfundimtare. Kontrata e shitjes nr. rep. {***}, nr. kol., {***}, dt. 13.03.2009, notere V. S.

dh) Sipas kontratës noteriale “Shitblerje prone, pasurie të paluajtshme apartament banimi (me rezervë)” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2010, subjekti i rivlerësimit ka shitur sendin e paluajtshëm “apartament banimi” I-I, me sipërfaqe totale ndërtimore 120,3 m², të cilën e zotëronte në bazë të “Aneks kontratës së sipërmarrjes” me nr. rep. {***} dhe nr. kol. {***}, datë 20.06.2007, ku pala shitëse është në rolin e pronares së truallit mbi të cilin është ndërtuar godina e banimit dhe e shërbimeve 4-5-6-7 kate. Sipas parashikimeve të kësaj kontrate, në nenin 3 të saj, çmimi i shitjes së apartamentit është përcaktuar 66.000 euro, i cili do të likuidohet: *Kësti i parë prej 60.000 eurosh është likuiduar jashtë kësaj zyre [...]. Këstin e dytë prej 6.000 (gjashtë mijë) eurosh pala blerëse do e likuidojë me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit. Akti përfundimtar i shitblerjes së pronës sipas ligjit do të kryhet kur të kryhet regjistrimi përfundimtar i pronës objekt kontrate, sipas ligjit.* Më tej, në kontratë, në nenin 4 të saj, përcaktohet se akti përfundimtar i shitblerjes së pronës do të kryhet kur të bëhet i gjithë regjistrimi i objektit në ZVRPP Tiranë.

e) Në DIPPV-në e vitit 2010, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja me rezervë e apartamentit të ndodhur në komunën {***}, me sipërfaqe 120 m². Çmimi i shitjes 66.000 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) euro. Nga çmimi i shitjes janë arkëtuar 60.000 euro. Kontrata me nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, dt. 04.03.2010, notere V. S.*

ë) Në datën 02.12.2014, nëpërmjet “Akt shkëmbim pasurie të paluajtshme njësi, garazh, apartament banimi dhe truall” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të lidhur para noteres V. S., subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë rënë dakord të shkëmbejnë pasuritë në emër të tyre, përkatësisht truallin me sipërfaqe 830 m² me tetë pasuri të paluajtshme, konkretisht 2 garazhe, 1 njësi dhe 5 apartamente banimi, sipas të dhënave specifike të përcaktuara shprehimisht në kontratë, identifikuar fillimisht në “Aneks kontratën e sipërmarrjes” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2007, para noteres V. S. Kalimi i pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme sipas kësaj kontrate noteriale, është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit pranë ZVRPP Tiranë më datë 09.12.2014.

f) Në DIPPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e pasurisë së paluajtshme “tokë arë” me sip. 830 m² pas ekzekutimit të kontratës së shkëmbimit me shoqërinë “{***}” ShPK dhe shtimin e pasurisë në sipërfaqe ndërtimi, sipas kontratës së sipërcituar, duke identifikuar individualisht, përkatësisht të gjitha pasuritë e paluajtshme të fituara në kuadër të kësaj kontrate shkëmbimi. Subjekti rezulton të ketë deklaruar edhe aktet përfundimtare të shitjes së dy apartamenteve, të shitura paraprakisht (me rezervë) në vitet 2009 dhe 2010, kalimi i pronësisë së të cilave nuk mund të realizohet deri në regjistrimin e objektit pranë ZVRPP Tiranë dhe kalimin e pronësisë së këtyre dy pasurive individuale në emër të subjektit të rivlerësimit.

24. Në analizë të fakteve dhe rrethanave si më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e tij periodike lidhur me marrëdhënien e krijuar me shoqërinë “{***}” ShPK dhe pasuritë e pakësuara dhe të shtuara të subjektit të rivlerësimit, si pasojë e kësaj

sipërfaqja e banimit prej 657,7 m², është ndarë sipas kateve teknike, në apartamente të identifikuara konkretisht mbi planimetritë e kateve të banimit.

marrëdhënieje juridike dhe interesit privat, pasuror që ka buruar prej saj, sikundër dhe me deklarin e të ardhurave të fituara nga shitja (me rezervë) e dy prej këtyre pasurive të paluajtshme (pa fituar ende titullin e pronësisë mbi to) ka respektuar parashikimet ligjore në fuqi.

25. Mosdeklarimi i marrjes në dorëzim të tetë pasurive të paluajtshme në vitin 2009 (pa fituar ende titullin e pronësisë mbi to), në vlerësim të trupit gjykues, nuk përbën shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, germa “a” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, mbi deklarin e pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë titulli i pronësisë së këtyre sendeve të paluajtshme ende nuk kishte kaluar te subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues konstatoi se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni në vendim, detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim dhe zotërim të subjekteve rivlerësuese është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në legjislacionin e posaçëm që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj dispozite ligjore, interpretuar kjo sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e të njëjtit ligj, në drejtim të zbërthimit të konceptit të pasurisë, objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë shtrihet edhe në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të subjekteve të rivlerësimit, të cilat janë jo vetëm në pronësi, por edhe në posedim ose përdorim të tyre. Trupi gjykues çmon se një arsyetim i tillë mbështetet edhe nga përmbajtja e kërkesave për deklarim sipas deklaratës së interesave privatë periodikë, e cila ndryshon nga deklarata e pasurisë *vetting*, ku në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, subjekteve të rivlerësimit u është kërkuar të deklarojnë me saktësi dhe në mënyrë të plotë çdo pasuri të paluajtshme në pronësi, posedim ose përdorim të tyre.
26. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu se, referuar parashikimeve të Kodit Civil mbi të drejtat reale, posedimi (sundimi faktik) i këtyre tetë sendeve të paluajtshme deri në kalimin e titullit të pronësisë dhe fitimin e tagrave të plotë të pronarit të ligjshëm të këtyre pasurive nuk konsiston në krijimin në favor të subjektit të rivlerësimit të ndonjë të drejte reale në sendin e tjetrit (*ius in re aliena*), për sa kohë nuk u provua nga hetimi administrativ në Komision që mbi këto sende të paluajtshme të jetë vendosur në favor të subjektit të rivlerësimit hipotekë, servitut, e drejtë përdorimi/banimi, uzurfrukti apo enfiteoze. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin që subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, as sa i takon detyrimit për deklarim të të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme.
27. Megjithatë, në kuadër të parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm mbi deklarin e interesave privatë të subjekteve deklaruese, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i marrjes në dorëzim të këtyre tetë sendeve të paluajtshme në vitin 2009, objekt i kontratës së shkëmbimit me shoqërinë “{***}” ShPK, mund ta bënte më të plotë deklarin e subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2009, në drejtim të pasqyrimin të ndryshimeve që kishte pësuar marrëdhënia tashmë e deklaruar e interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, që në vitin 2006, në raport me stadin në të cilin ndodhej marrëdhënia kontraktuale e shkëmbimit.
28. Në kontekst të sa më sipër, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e një deklarimi të pasaktë, trupi gjykues çmoi me rëndësi të vlerësojë nëse mënyra e deklarinin nga subjekti i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme të fituara nga marrëdhënia e shkëmbimit të tokës me sipërfaqe ndërtimore me shoqërinë {***} ShPK, në deklarinmet periodike përpara ILDKPKI-së e bën deklarinin e tij të pamjaftueshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit, për faktin se pasuritë e paluajtshme që ka fituar nga kjo marrëdhënie juridike subjekti nuk i ka deklaruar në vitin në të cilin i ka marrë në dorëzim (2009), por i ka deklaruar ato në deklaratën periodike të vitit në të cilin i ka kaluar pronësia mbi to, sipas kontratës noteriale “Akt shkëmbim pasurie të

paluajtshme, njësi, garazh, apartament banimi dhe truall” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2014, para noteres V. S., dhe në vitin në të cilin është kryer regjistrimi i tyre pranë ZVRPP Tiranë në emër të subjektit të rivlerësimit.

29. Për efekt të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë faktin që këto pasuri të paluajtshme (një pjesë e tyre pasuri të deklaruara në deklaratën *vetting*) kanë origjinë dhe njëkohësisht burim krijimi marrëdhënien juridike të shkëmbimit të pasurisë ekzistuese në atë kohë të subjektit të rivlerësimit me sipërfaqe ndërtimore të një objekti të ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse mbi pasurinë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
30. Marrëdhënia e shkëmbimit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni si një marrëdhënie juridiko-civile, e cila nuk është lidhur apo ekzekutuar në kushtet e konfliktit të interesit mes shoqërisë investuese dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e zyrtarit, sipas parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi. Sikundër dhe as ka rezultuar, pas hetimit të thelluar të Komisionit dhe të shtrirë deri në verifikimin e marrëdhënieve kontraktuale të shoqërisë investitore me të tjerë pronarë të trojeve të përfshira në sipërmarrjen për zhvillimin e kryer, që subjekti të ketë përfituar kushte apo trajtim preferencial krahasuar me pronarët e tjerë të tokave, çka mund të ngrinte hije dyshimi mbi përfitime të paligjshme për shkak të detyrës së tij.
31. Referuar tërësisë së akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, trupi gjykues konstatoi se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës mosdeklarimi i faktit të marrjes në dorëzim të apartamenteve në vitin 2009 dhe i posedimit të tyre deri në vitin 2014, vit në të cilin janë deklaruar, të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këto pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij sipas legjislacionit në fuqi për deklarimin e pasurive dhe shmangien e konfliktit të interesit. Gjithashtu, nga hetimi administrativ, nuk rezultoi e provuar që me këtë veprim (mosdeklarimin në DIPPV-në e vitit 2009 të marrjes në dorëzim të pasurive të paluajtshme nga shoqëria ndërtuese, apo qoftë edhe në deklaratat e viteve pasuese deri në vitin 2014) subjekti i rivlerësimit të ketë pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI-së) këto pasuri të paluajtshme dhe veprimet lidhur me to, apo të ketë krijuar të ardhura nga përdorimi/shfrytëzimi/disponimi i tyre, të cilat të mos i ketë deklaruar rregullisht. Përkundrazi, konstatohet se në saje të deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, ILDKPKI-ja kishte mundësi të verifikonte në çdo kohë jo vetëm pasuritë e subjektit të rivlerësimit, marrëdhënien e tij me personin e lidhur (shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK), transaksionet e deklaruara nga disponimi i këtyre pasurive dhe krijimin e të ardhurave prej tyre, por edhe të ushtronte kontroll mbi pasuritë e shoqërisë “{***}” ShPK dhe burimet e krijimit të tyre në kuadër të parashikimeve të ish-nenit 7¹¹ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, për sa kohë kjo shoqëri ishte deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit që në DIPPV-në e vitit 2006, si person i lidhur me të, si pasojë e lidhjes së interesit që ishte krijuar me hyrjen në marrëdhënie kontraktuale të shkëmbimit të pronës.
32. Në përfundim, lidhur me këtë shkak të ankimit, referuar sa më sipër analizuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se mosdeklarimit të faktit të marrjes në dorëzim të pasurive në DIPPV-në e vitit 2009 apo edhe në DIPPV-të vijuese, deri në vitin 2014, referuar legjislacionit të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar, si dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, nuk mund t’i atribuohen efektet e deklarimit të pamjaftueshëm të 8 pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, të fituara nga transaksioni i shkëmbimit të pronës me shoqërinë “{***}” ShPK,

¹¹ Tani neni 9 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga kontrolli i kryer mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e parashikuara nga ndonjë prej rasteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 33, pika 5, shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, të cilat zbërthejnë në ligj parashikimet kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, se përfundimi i arritur nga Komisioni është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit mbi faktet juridike të provuara gjatë hetimit administrativ.

33. Lidhur me vlerësimin e pasurisë së llojit “tokë arë” me sip. 830 m², të blerë me kontratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2000, në prani të noteres B. H., për të cilën subjekti pretendoi se konkluzioni i arritur nga Komisioni se ai nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë “tokë arë” me sipërfaqe 830 m², e cila ka shërbyer si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shoqëria “{***}” ShPK, është i pabazuar në ligj dhe rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
34. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se ky i fundit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 830 m², e cila ka shërbyer në vijim si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shoqëria “{***}” ShPK. Këtë konkluzion Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, i ka rezultuar që shitësi i kësaj pasurie të paluajtshme, z. F. A., si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, ka përfituar tokë bujqësore sipas dy AMTP-ve të ndryshme, të lëshuara në periudha të ndryshme dhe në mënyrë të pakuptueshme, si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, duke e bërë të pabesueshme origjinën e përfitimit të sipërfaqes prej 830 m². Veç kësaj, Komisioni është shprehur në vendim se bindjen e tij për të arritur në këtë vlerësim, e kanë përforcuar edhe disa fakte të cilat lidhen me elementet formale të dy AMTP-ve, të lëshuara përkatësisht në datat 01.08.1992 dhe 20.04.1999.
35. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, ka ngritur në ankimin e tij pretendimet e mëposhtme.

35.1. Ngarkimi me përgjegjësi i subjektit të rivlerësimit për të mosprovuarin e burimit të krijimit të pasurisë tokë arë me sip. 830 m² në {***}, për shkak të problematikave të AMTP-së në aspektin formal, nuk bazohet në ligj dhe është në thelb një akuzë e paligjshme. Verifikimi i ligjshmërisë së përfitimit të tokës nga shitësi, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është objekt i hetimit të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kushtet kur nga hetimi i kryer është provuar mungesa e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësit të tokës. Në çdo rast, subjekti pretendoi se çfarëdo problematike që mund të kenë pasur AMTP-të e shitësit, përgjegjës për këtë fakt nuk mund të bëhet blerësi i tyre në mirëbesim.

35.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se ky përfundim i Komisionit është arritur në shkelje flagrante të procesit të rregullt ligjor, duke qenë se “gjetja” nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë arë, e cila ka shërbyer si shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, i është bërë e njohur nga Komisioni subjektit të rivlerësimit, për herë të parë në arsyetimin e vendimit. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, kishte detyrimin që të bënte me dije gjetjen, në këndvështrimin e problematikave të pretenduara të AMTP-së së shitësit, në mënyrë që subjekti të kishte mundësinë të realizonte të drejtën e

mbrojtjes efektive, në kuptim të një procesi të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”).

36. Në kuadër të vlerësimit të këtij shkakut ankimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së, për vitin 2003 ka deklaruar si pasuri të tij të akumuluar pronësinë mbi një tokë bujqësore me sip. 830 m² në {***} ({***}), Tiranë. Konstatohet se origjina e pasurisë tokë arë me sip. 830 m², në {***}, të krijuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2000, ka qenë “kontrata e shitblerjes tokë arë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2000, para noteres B. H.”, ndërsa burimet e krijimit të kësaj pasurie, në vlerën prej 415.000 lekësh, sipas deklaramentit të subjektit të rivlerësimit, kanë qenë fitimet e realizuara prej tij çdo vit.
37. Referuar kontratës së shitblerjes, pasuria objekt kontrate ka qenë në pronësi të shtetasit F. S. A., regjistruar pranë ZVRPP Tiranë me të dhënat nr. pasurie {***}, ZK nr. {***}, Vol. {***}, f. {***}, provuar ky fakt sipas certifikatës për vërtetim pronësie dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se referuar dispozitave të zbatueshme të Kodit Civil lidhur me veprimet juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme, neneve 83, 163, 195 dhe 750 të Kodit Civil, origjina e kësaj pasurie vlerësohet e ligjshme. Gjithashtu, referuar rezultateve të hetimit dhe analizës financiare të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se justifikon me burime të ligjshme krijimin e saj¹².
38. Trupi gjykues konstatoi se krijimi i kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit është hetuar edhe në drejtim të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi mes subjektit të rivlerësimit dhe mbajtësit të AMTP-së, z. F. A. apo dhe dy anëtarëve të tjerë të familjes bujqësore (F. A. dhe A. A.), të cilët në cilësinë e bashkëpronarëve të tokës arë me sip. 830 m² kanë lidhur kontratën e shitblerjes me subjektin e rivlerësimit. Si rezultat i këtij hetimi administrativ, Komisioni bazuar edhe në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore ku ka ushtruar detyrën e prokurorit subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është gjetur në konflikt interesi me personat e sipërcituar, pasi rezultoi se nuk ka pasur procedime penale në ngarkim të tyre.
39. Në analizë të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të pasurisë tokë arë me sip. 830 m² dhe përfundimit të arritur prej tij, se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie e cila ka shërbyer si origjinë për krijimin e pasurive të paluajtshme nga marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë “{***}” ShPK, duke e lidhur këtë përfundim me problematika të konstatuara, sipas Komisionit, në drejtim të aktit të marrjes së tokës në pronësi nga shitësi F. A., trupi gjykues çmoi të nevojshme kryerjen e një analize juridike lidhur me kufijtë e kontrollit të pasurisë së subjekteve rivlerësimit nga organet e rivlerësimit, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këtë kontekst, në kuadër të parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramentit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohet ligjërisht* [...]. Referuar këtij parashikimi kushtetues, organet e rivlerësimit kanë për detyrë të verifikojnë ligjshmërinë e pasurive të subjekteve të rivlerësimit në drejtim të origjinës së tyre të ligjshme dhe burimeve të ligjshme të krijimit, duke përfshirë dhe mjaftueshmërinë e këtyre burimeve.

¹² Shih konkluzionin në f. 2 të analizës financiare të Komisionit për periudhën 1997-2000, sipas të cilit: “Në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit ka pasur aftësi paguese për të blerë tokën me sip. 830 m² në {***}, me çmim 415.000 lekë, si dhe për të blerë apartamentin me kreditë e marrë në Bankën e Kursimeve.

40. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të kriterit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur të tij. Në kuadër të këtij parashikimi ligjor, me qëllim realizimin e procesit të kontrollit nga ana e organeve rivlerësuese, subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin që së bashku me deklaratën e pasurisë (*vetting*), të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve të tyre mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të deklaruara, detyrim i cili shtrihet në raport me vërtetësinë e origjinës dhe ligjshmërisë së burimit të krijimit prej tyre të pasurive të deklaruara.
41. Ndërkohë që referuar parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit së bashku me *personat e lidhur* me ta apo *personat e tjerë të lidhur* me ta, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, ngarkohen me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara dhe në dritën e jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, trupi gjykues gjen me vend të theksojë se detyrimi i *personave të tjerë të lidhur* me subjektin e rivlerësimit dhe i këtyre të fundit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive objekt kontrolli (përfshirë dhe ligjshmërinë e origjinës së tyre) lind vetëm në rastin e gjendjes së subjekteve të rivlerësimit në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për gamën e transaksioneve të përcaktuara shprehimisht në këtë dispozitë ligjore, dhe lidhur me pasuritë objekt të këtyre transaksioneve.
42. Në përmbyllje të kësaj analize, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në kundërshtim me kuadrin kushtetues dhe ligjor që normon procesin e rivlerësimit, ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me kontrollin e pasurisë së paluajtshme të fituar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet “kontratës së shitblerjes tokë arë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2000, para noteres B. H.”. Komisioni ka konstatuar në mënyrë të gabuar situatën faktike mbi bazën e së cilës do duhej të zgjidhte çështjen objekt gjykimi dhe, për rrjedhojë, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, duke arritur në konkluzionin se nuk provohet bindshëm origjina e ligjshme e krijimit të pasurisë “tokë arë” me sip. 830 m² nga shitësi dhe, rrjedhimisht, duke i ngarkuar subjektin të rivlerësimit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, barrën e të provuarit dhe pasojat e të mosprovuarit bindshëm të burimeve dhe të origjinës së krijimit të pasurisë nga ana e palës shitëse. Për më tepër që nga hetimi administrativ nuk rezultoi asnjë e dhënë për situatën e cilat mund të ngrinin dyshime të arsyeshme në drejtim të ligjshmërisë së përfitimit të kësaj pasurie të paluajtshme nga subjekti i rivlerësimit, sikundër janë: (i) qenia e subjektit të rivlerësimit në keqbesim lidhur me “problematikat” e pretenduara nga Komisioni mbi titullin e pronësisë së shitësit; apo (ii) ekzistenca e gjendjes së konfliktit të interesit me shitësin/sit e kësaj pasurie të paluajtshme.
43. Edhe pse në kuadër të analizës së sipërcituar, për nevoja të vlerësimit të saktësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme tokë arë me sip. 830 m², si dhe të kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të saj, rezultoi e panevojshme analiza në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së origjinës dhe burimit të krijimit të kësaj pasurie nga ana e shitësit, z. F. S. A., në kuadër të transparencës dhe në funksion të interesit të publikut në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, trupi gjykues çmoi me rëndësi shqyrtimin e dokumentacionit të fashikullit të krijuar nga hetimi i kryer në Komision dhe verifikimin e situatës ligjore lidhur me vlefshmërinë e titullit të pronësisë së z. F. S. A., nga ku konstatoi dhe vlerësoi sa më poshtë vijon.

a) Z. F. S. A., pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme objekt kontrolli, e ka fituar nëpërmjet AMTP-së nr. {***}, datë 01.08.1992. Ky fakt rezultoi i provuar nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2019, me të cilën paraqitet historiku i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr. {***}, zk. {***}, që prej origjinës së saj.

b) Nga shqyrtimi i hollësishëm i këtij dokumentacioni të përcjellë nga ZVRPP Tiranë, u konstatua se pasuria nr. {***} (pasuria tokë arë me sip. 830 m²), e cila në datën e kontratës së shitblerjes ka qenë e regjistruar në pronësi të z. F. S. A., figuron e regjistruar në Vol. nr. {***}, f. {***}, e cila vijon nga Vol. nr. {***}, faqe {***}, që sipas certifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar më datë 31.08.1999, i korrespondon pasurisë me nr. {***}, me sip. 2500 m². Referuar kërkesës së z. F. A. me nr. serie {***}, pasuria me nr. {***} është kërkuar të ndahet për efekt shitjeje, duke përcaktuar në këtë mënyrë pasurinë e blerë nga subjekti i rivlerësimit me nr. pasurie {***}. Ndërkohë vetë pasuria me nr. {***}, referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, rezulton e regjistruar në Vol. {***}, faqe {***}, dhe rrjedh nga pasuria e regjistruar në Vol. {***}, faqe {***}, e cila rezulton të jetë pasuria me nr. {***}, me sipërfaqe 2850 m² dhe me referencë akti nr. {***}, e regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, më datë 25.12.1996, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. {***}, datë 01.08.1992, ku evidentohet parcela e tokës arë me sip. 2850 m². Për rrjedhojë, trupi gjykues konstatoi se ndryshe nga sa është shprehur Komisioni në dokumentin “Rezultati i hetimeve”, si dhe në arsyetimin e vendimit të tij, pasuria e fituar nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës noteriale të shitblerjes mes tij dhe z. F. A., rrjedh nga parcela e tokës arë me sip. 2850 m² që i është dhënë z. F. A. sipas AMTP-së me nr. {***}, më datë 01.08.1992, dhe është regjistruar përkatësisht sipas këtij akti në ZVRPP Tiranë, më datë 25.12.1996, dhe jo nga AMTP-ja me nr. {***}, e datës 20.04.1999. Sa më sipër, hedh poshtë edhe konkluzionin tjetër të Komisionit, se në momentin e kryerjes së negociatave për shitblerjen e tokës nga subjekti i rivlerësimit, z. F. A. nuk ka qenë i pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

44. Sa i takon ekzistencës së korigjimeve në AMTP-së nr. {***}, datë 01.08.1992, trupi gjykues pasi verifikoi dokumentin e sipërcituar, në pamje të parë konstatoi se, nga kryqëzimi i të dhënave lidhur me sipërfaqet e tokës të përcaktuara në rubrika të ndryshme të këtij dokumenti, korigjimet të cilave u referohet Komisioni, nuk evidentojnë mospërputhje apo korigjime të sipërfaqes së tokës së dhënë fillimisht, çka logjikisht mund të ngrinte dyshime të arsyeshme në drejtim të ndërhyrjeve të paautorizuara në madhësinë e sipërfaqes së tokës të akorduar fillimisht në pronësi. Pavarësisht konstatimit të mësipërm, trupi gjykues çmoi se dyshimet e ngritura nga ana e Komisionit lidhur me ekzistencën e korigjimeve në AMTP-së, nuk janë objekt i shqyrtimit të organeve të rivlerësimit, por i komisioneve vendore të vlerësimit të pronësisë (KV-ve)¹³, të ngritura në kuadër të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstatoi se nga hetimi administrativ i Komisionit nuk është administruar asnjë e dhënë, sipas së cilës AMTP-ja nr. {***}, datë 01.08.1992, të jetë deklaruar e pavlefshme, në zbatim të nenit 10¹⁴ të

¹³ Qëndron si shkurtim për “komisionin vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë”.

¹⁴ Në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008, në nenin 10, “Procedurat për titujt e pronësisë, të krijuar në kundërshtim me ligjin”, parashikohet shprehimisht:

“1. Kur komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV-ja), gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe të vendimeve përkatëse të komisioneve të tokës, vëren se krijimi i titullit të pronësisë mbi tokën është dhënë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të këtij ligji dhe me vendimet e tij, të marra sipas neneve 8, pikat 2 e 3 dhe 9, pika 2 e këtij ligji, i paraqet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ, “akti i marrjes së tokës në pronësi”.

ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar. Ky konstatim mbështetet edhe nga të dhënat e administruara nga regjistri i pasurive të paluajtshme, sipas të cilit titulli i pronësisë mbi këtë parcelë toke i është dhënë z. F. A. sipas kësaj AMTP-je dhe asnjë korrigjim i mëpasshëm nuk rezulton të jetë regjistruar lidhur me sa më sipër.

45. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se Komisioni, përveçse ka gabuar në vlerësimin se subjekti i rivlerësimit është përgjegjës për të mosprovuarin bindshëm të ligjshmërisë së origjinës/burimit të krijimit të pasurisë tokë arë nga shitësi F. A., edhe konkluzionin e arritur se për shkak të problematikave lidhur me AMTP-të e shitësit, bëhet e pabesueshme origjina e përfitimit të sipërfaqes së tokës prej 830 m² nga z. F. S. A., e ka të pabazuar në fakte, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ të kryer prej tij për këtë qëllim.
46. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se ky përfundim i Komisionit është arritur në shkelje flagrante të procesit të rregullt ligjor, duke qenë se “gjetja” nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë arë në këndvështrimin e problematikave në aspektin formal të AMTP-ve të shitësit –gjetje e cila ka shërbyer si shkak për ngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si subjekt që ka dështuar në testin e kontrollit të pasurisë objekt gjykimi dhe, për rrjedhojë, dhënie e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra – i është bërë e njohur për herë të parë në arsyetimin e vendimit, trupi gjykues vëren se:
- Referuar akteve të fashikullit të Komisionit, konkretisht nga verifikimi i dokumentit “Rezultatet e hetimit” lidhur me gjetjet e Komisionit në drejtim të kriterit të pasurisë dhe kalimit të barrës së provës¹⁵, nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore¹⁶ të zhvilluar në Komision në datën 06.03.2019, si dhe nga shqyrtimi i pjesës arsyetuese të vendimit të Komisionit, vlerësuar në raport me përmbushjen e barrës së provës nga ana e subjektit të rivlerësimit, këtij të fundit konstatohet se nuk i është vënë në dukje, në kuadër të gjetjes nga rezultati i hetimit, ekzistenca e problematikave në aspektin formal të AMTP-së nr. {***}, datë 01.08.1992, dhe aq më pak t’i jetë bërë e ditur se ekzistenca e këtyre problematikave do t’i passillte pasojat juridike të një deklarimi të pamjaftueshëm, në rast të

2. Kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti i qarkut brenda 7 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për paligjshmërinë e aktit të pronësisë mbi tokën bujqësore. Objekt i kërkesës së prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së "aktit të marrjes së tokës në pronësi", shfuqizimi i tij dhe kthimi i pronës në pronësi të shtetit”.

¹⁵ Komisioni, referuar rezultateve të hetimit administrativ të njoftuara më datë 14.02.2019, në vlerësim të origjinës së krijimit të pasurive të paluajtshme të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, si pasojë e marrëdhënies juridike të krijuar me shoqërinë “{***}” ShPK, ka konstatuar dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtyre rezultateve:

[...]

(c) Shtetasi F. A. ka deklaruar se “me 7501 morëm tokën, me 1 gusht të vitit 1991”, ndërkohë, akti i marrjes së tokës në pronësi nga ky shtetas, i vënë në dispozicion nga ZVRPP Tiranë, ka datë lëshimi 20.04.1999. Sipas kësaj AMTP, ky shtetas nuk ka qenë i pajisur me akt pronësie në vitin 1996, kur pretendohet të jetë bërë marrëveshja midis palëve për shitjen e pasurisë. Subjekti të sqarojë, si është rënë dakord për shitjen e një trualli në këto kushte.

d) Ka paqartësi për mënyrën se si shtetasi F. A. ka kontaktuar me subjektin e rivlerësimit, dhe cila është arsyeja e rënies dakord për shitblerjen e një pasurie, pa dokument shkresor, në mirëbesim të plotë mes tyre. Subjekti të japë sqarime për këtë.

¹⁶ Referuar këtij procesverbalit, gjatë relatimit lidhur me hetimin e kryer për pasuritë e përfituara nga kontrata e shkëmbimit me shoqërinë “{***}” ShPK, rezulton që relatorja e çështjes është shprehur: “Në lidhje me këto pasuri dhe të tjera të përfituara nga shoqëria “{***}” ShPK, nga ana e Komisionit është kryer një hetim i thelluar administrativ dhe është verifikuar origjina e krijimit të tyre, nga ku ka rezultuar se: -Trualli prej 830 m², ka qenë në pronësi të familjes së shtetasit F.A., përfitur sipas ligjit 7501, datë 19.07.1991 [...]”.

mosprovuarit të së kundërtës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se kjo mënyrë të proceduari nga ana e Komisionit përbën shkelje të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

- Kjo shkelje e rëndë procedurale, e cila, në zbatim të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, u nënshtrohet kompetencave korigjuese të Kolegjit, vlerësohet nga trupi gjykues pa ndikim në rastin konkret, në drejtim të formës së gjykimit të çështjes dhe nevojës për t'i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në seancë gjyqësore publike lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, për sa kohë në dritën e analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin që ky konkluzion i Komisionit (lidhur me vlerësimin e vlefshmërisë së AMTP-së) nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar.

47. Në përfundim të sa më sipër analizuar, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin nga Komisioni të krijimit të pasurisë së paluajtshme tokë arë me sip. 830 m² në {***}, Tiranë dhe, për rrjedhojë, të gabuar dhe të pambështetur në fakte dhe në ligj, konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri.

48. *Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me kundërshtimin nga subjekti i rivlerësimit të përfundimeve të arritura nga Komisioni mbi huapërdorjen e dy prej apartamenteve të subjektit të rivlerësimit nga znj. S. Sh. dhe z. M. G., si dhe huapërdorjen e një vend parkimi nga shtetasi R. S. pas vitit 2015, si të padrejta, të pabazuara dhe rrjedhojë të një procesi në cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

49. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me huapërdorjet e pasurive të subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij se, me kalimin e barrës së provës, subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente shpresore që të vërtetojë se znj. S. Sh. dhe z. M. G. nuk kanë pasur në pronësi pasuri të tjera të paluajtshme në Tiranë, në periudhën që ata kanë marrë në huapërdorje pasuritë e subjektit të rivlerësimit. Sa i takon huapërdorjes së një vendi parkimi nga z. R. S., Komisioni është shprehur se është e paqartë se përse subjekti ka vijuar t'ia lejë në përdorim pa shpërblim garazhin shtetasit R. S., pas vitit 2015, në kushtet kur ai vetë ka pasur mundësi t'i administrojë pasuritë e tij, nga të cilat tri apartamente tashmë i kishte shitur. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se këto marrëdhënie huapërdorjeje janë të dyshimta.

50. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë huapërdorjes së dy prej apartamenteve në pronësi të tij në {***} ({***}), nga znj. S. Sh. (vjehrra e subjektit) dhe z. M. G., si dhe përdorimit pa shpërblim të një vendi parkimi në të njëjtën ndërtesë në {***}, nga shtetasi R. S., ka ngritur pretendimet e mëposhtme në ankimin e tij.

50.1. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të padrejtë i ka ngarkuar përgjegjësinë e mosvërtetimit të faktit se shtetasi S.Sh. dhe M.G., në cilësinë e huapërdoruesve, nuk kanë pasur në pronësi pasuri të paluajtshme në qytetin e Tiranës, gjatë periudhës që kanë përdorur pa shpërblim pasuri të paluajtshme në pronësinë e tij, për sa kohë këtë fakt Komisioni nuk ia ka nënshtuar hetimit administrativ dhe as i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të qartë, barrën e provës për të provuar të kundërtën. Subjekti pretendon gjithashtu se Komisioni ka interpretuar në mënyrë jo të drejtë përgjigjen e subjektit të rivlerësimit sa i takon çështjes së përkujdesjes ndaj një prej huapërdoruesve, vjehrrës së tij, znj. S. Sh.

50.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se moskalimi në mënyrë të qartë i barrës së provës lidhur me këtë çështje dhe ngarkimi i përgjegjësisë së të mosprovuarit të këtij fakti, ka cenuar procesin e rregullt ligjor duke qenë se subjekti i është mohuar mundësia e të provuarit të së

kundërtës. Për efekt të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar marrjen në shqyrtim nga trupi gjykues të dokumentacionit përkatës provues, të cilin e ka depozituar bashkëlidhur ankimit.

50.3. Për subjektin e rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit është e paqartë se përse subjekti i rivlerësimit ka vijuar t'ia lërë në përdorim pa shpërblim garazhin shtetasit R. S. pas vitit 2015, në kushtet kur ai vetë ka pasur mundësi t'i administronte pasuritë e tij, nga të cilat tri apartamente tashmë i kishte shitur, është një konkluzion i padrejtë dhe i pabazuar.

51. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi dhe pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të tij, referuar edhe arsyetimit të Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi fillimisht se Komisioni, në trajtimin e marrëdhënieve të huapërdorjeve të pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se këto marrëdhënie vihen në dyshim dhe, për rrjedhojë, këtë vlerësim e ka renditur ndër faktet të cilat kanë shërbyer për Komisionin si bazë për arritjen në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me pasuritë e tij, edhe pse nuk rezultoi të ketë argumentuar se si huapërdorjet e këtyre pasurive e bëjnë deklaramin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me to, të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar kjo në kuptim të rasteve shprehimisht të përcaktuara në nenin 33, pika 5 e të njëjtit ligj.
52. Më tej, trupi gjykues konstatoi se për Komisionin, është pikërisht mungesa e paraqitjes së dokumentacionit shkresor lidhur me pasjen ose jo në pronësi nga huapërdoruesit S. Sh. dhe M. G., të pasurive të paluajtshme në qytetin e Tiranës, në kohën e deklaram të huapërdorjes, fakti që e bën të dyshimtë përdorimin pa shpërblim të këtyre banesave, edhe pse Komisioni nuk ka treguar në vendimin e tij se si dhe në çfarë mënyre do të ndikonte vërtetimi i faktit të pasjes apo jo në pronësi të pasurive të tjera në marrëdhënien e huapërdorjes së këtyre personave me subjektin e rivlerësimit dhe se si kjo e fundit do të mund të kualifikonte ose jo deklaramin e subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit, si deklaram të pamjaftueshëm.
53. Në këtë kontekst të paqartë të arsyetimit të Komisionit në vendimin objekt ankimi, duke marrë parasysh që konkluzioni i Komisionit duket se lidhet formalisht me mospërbushjen nga ana e subjektit të rivlerësimit të barrës së provës mbi pasjen ose jo të pasurive në pronësi nga ana e personave të sipërcituar, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e fashikullit të çështjes, konstatoi sa më poshtë.
- a) Sa u takon dy huapërdorjeve të pasurive të paluajtshme nga personat S. Sh. dhe M. G., subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë sqarime lidhur me shkaqet e dhënies së pasurive të tij personave të sipërcituar në përdorim, pa kundërshtim, si dhe është pyetur nëse këta persona kanë pasur apo jo pasuri të paluajtshme në pronësi të tyre në Tiranë, gjatë kohës së huapërdorjes, çështje këto të cilat janë adresuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në "Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe kërkesa për prova", të datës 28.02.2019, drejtuar Komisionit¹⁷.
- b) Nga formulimi i rezultateve të hetimit lidhur me huapërdorjet nga znj. S. Sh. dhe z. M. G., vërehet se subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar shprehimisht vënia në dispozicion të Komisionit e dokumentacionit që provon gjendjen pasurore të këtyre dy personave, sikundër ka ndodhur në rastin e rezultateve të hetimit mbi huapërdorjen e 1/3 së njërit prej garazheve të subjektit të rivlerësimit nga z. R. S., për të cilën subjektit të rivlerësimit i është kërkuar shprehimisht: *Subjekti të vejë në dispozicion dokument që nuk vërtetohet konflikti i interesit me këtë shtetas, si dhe të vërtetohet faktin që ai është administrator i pallatit.*

¹⁷ Shih shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në pikat 8 dhe 9 të dokumentit (faqe 8 dhe 9).

c) Për më tepër, subjektit të rivlerësimit nuk i është bërë e ditur nga ana e Komisionit se të mosprovarit e pasjes apo jo të pasurive të paluajtshme në pronësi nga ana e huapërdoruesve të apartamenteve të tij, znj. S. Sh. dhe z. M. G., do të kualifikohet nga Komisioni si një fakt i cili do të sillte pasoja juridike në dëm të subjektit të rivlerësimit në drejtim të rezultatit mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë.

54. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për moskalimin e barrës së provës nga ana e Komisionit në mënyrë të qartë, është i bazuar dhe, për rrjedhojë, shkaku i ankimit, sipas të cilit ngarkimi i subjektit të rivlerësimit me përgjegjësinë e të mosprovarit të këtij fakti ka cenuar procesin e rregullt ligjor në Komision, duke qenë se subjektit të rivlerësimit i është mohuar mundësia e të provuarit të së kundërtës, gjendet i drejtë dhe i bazuar.
55. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues çmon se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provave të reja të akteve “Deklaratë noteriale” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.04.2019 dhe “Vërtetim nr. {***} prot., datë 15.04.2019” i ZVRPP Tiranë, me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë se vjehrra e tij, znj. S. Sh., nuk ka pasur dhe nuk ka pasuri të paluajtshme në Tiranë dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur pasuri as gjatë periudhës kur ka qëndruar në një prej apartamenteve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të akteve “Deklaratë noteriale” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.04.2019 dhe “Vërtetim nr. {***}, datë 15.04.2019” i ZVRPP Tiranë, me anë të të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë që z. M. G. nuk ka pasuri të paluajtshme në qytetin e Tiranës, plotëson kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, pasi nevoja për të provuar këto fakte juridike ka lindur pas dhënies së vendimit nga ana e Komisionit.
56. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se shqyrtimi i kërkesës së subjektit për marrjen e akteve të sipërcituara në cilësinë e provave të reja, i nënshtrohet edhe vlerësimit në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se nevoja e të provuarit të fakteve të sipërcituara duhet të vlerësohet në raport me efektin e tyre në zgjidhjen e çështjes, në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Më konkretisht, shtrohet pyetja: A është e nevojshme të provohet një fakt i tillë? (pasja apo mospasja e pasurive të paluajtshme në pronësi nga huapërdoruesit) – për të cilin Komisioni shprehet se vetëm në këtë rast do të kishte vend për të arsyetuar në lidhje me shkaqet e pretenduara të dhënies në huapërdorje të kësaj pasurie z. G., kur ndërkohë referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, nuk rezulton që shkaku për dhënien e një apartamenti banimi në huapërdorje z. G. gjatë periudhës së deklaruar, të lidhet me pasjen apo mospasjen prej tij të pasurive të paluajtshme në pronësi në Tiranë gjatë kësaj periudhe¹⁸?

¹⁸ Në lidhje me kërkesën e Komisionit për të dhënë sqarime lidhur me marrëdhëniet me shtetasin M. G. dhe arsyet e dhënies në huapërdorje të dy pasurive, subjekti është përgjigjur: “Shtetasi M. G. është mik i shtetasit R. S. dhe njohja ime me të është bërë nëpërmjet këtij të fundit. Arsyet e dhënies në huapërdorje të apartamenteve janë disa: Së pari, sikurse mund të konstatohet, qysh prej vitit 2009, kur apartamentet janë marrë në dorëzim e për disa vjet (kur janë dhënë në përdorim), ato kanë qenë të mbyllura dhe në vijimësi paraqisnin probleme që shkaktoheshin nga mospërdorimi i tyre, si lagështia, apo myku etj. Së dyti, për shkak të largësisë nga Tirana dhe mungesës së transportit, fillimisht nuk ka pasur as kërkesa për qira. Së treti, qëllimet e mia në raport me këto apartamente ishin shitja e tyre dhe jo lënia me qira pasi konstatoja se edhe kur filloi të kishte kërkesë për qira në atë zonë, ato ishin mjaft të ulëta dhe të paleverdishme në raport me dëmet që mund të shkaktonte një qiramarrës prej një përdorimi të pakujdesshëm. Së katërti, për shkak të përmirësimit të gjendjes sime financiare prej marrjes së apartamenteve në {***}, në raport me gjendjen e mëparshme, unë nuk kam synuar të nxjerr përfitime nga qiraja të cilat mund të ishin më të vogla se dëmtimet e mundshme. Në këto kushte, gjykova se ishte më e arsyeshme t’ia jepja në përdorim një të njohuri, i cili do të kujdesej për apartamentin sesa një qiramarrësi, i cili mund ta dëmtonte atë. Në rrethanat e

57. Gjithashtu, edhe në rastin e huapërdorjes nga znj. Sh., vjehrra e subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton që shkak i huapërdorjes të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si i lidhur me pasjen apo mospasjen nga znj. Sh. të pasurive të paluajtshme në pronësi në Tiranë¹⁹.
58. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se do të ishte pa efekt për shqyrtimin e çështjes administrimi i këtyre provave të reja, për sa kohë Komisioni nuk ka treguar në mënyrë të qartë se si do të mund të ndikonin ato në vlerësimin e marrëdhënies së huapërdorjes dhe se si këto të fundit do të ndikonin në vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në zbatim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit për marrjen e këtyre akteve në cilësinë e provave të reja.
59. Në kuadër të shqyrtimit të marrëdhënieve të sipërcituara të huapërdorjes, nga verifikimi i akteve të fashikullit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur me z. M. G. 2 kontrata huapërdorje, një kontratë lidhur më datë 05.02.2014, për apartamentin me sip. 86 m² në katin e katërt të godinës shumëkatëshe, me afat të pacaktuar dhe të drejtë për zgjidhje të kontratës në çdo kohë dhe një kontratë të dytë huapërdorjeje mes të njëjtave palë për apartamentin në katin e dytë të godinës, të lidhur më datë 18.07.2015, me të njëjtat kushte si në kontratën e parë. Ndërkohë marrëdhënia e huapërdorjes me znj. S. Sh. (vjehrra e subjektit të rivlerësimit), sikundër me të drejtë ka konstatuar edhe Komisioni, ka qenë e paformalizuar me kontratë.
60. Referuar sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procedurës së hetimit administrativ²⁰, ky i fundit është shprehur: *Në lidhje me apartamentet e shitura në vitet 2015 dhe 2018, faturat janë likuiduar pjesërisht nga ana ime dhe pjesërisht nga persona që unë ua kam dhënë në huapërdorje banesat për t'i përdorur dhe mirëmbajtur. Kështu, për apartamentin e shitur në vitin 2015 (kati 4), [...] nga shkurti i vitit 2014 deri në korrik të vitit 2015 janë paguar nga shtetasi M. G. në emrin tim, të cilit i ishte dhënë në huapërdorje (bashkëlidhur kontrata e huapërdorjes). Në shtator 2015, apartamenti është shitur. Në lidhje me apartamentin e shitur në vitin 2018 (kati i dytë) [...] nga korriku 2015 e deri në korrik të vitit 2018, janë paguar nga shtetasi M. G. në emrin tim, i cili pas shitjes nga unë të apartamentit në katin e katërt, kaloi me të njëjtin status, si huapërdorues, në apartamentin e katit të dytë (bashkëlidhur kontrata e huapërdorjes) [...]. Në periudhën korrik 2013 - qershor 2015 është përdorur nga vjehrra ime, e quajtur S. Sh., në kushtet e huapërdorjes dhe në periudhën korrik 2015 - korrik 2018, është përdorur nga shtetasi M. G. po si huapërdorues, kohë kur e ka dorëzuar atë pasi iu shit shtetases L. D.*
61. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se hetimet e kryera nga Komisioni nuk prodhuan asnjë konkluzion, gjetje apo qoftë të dhëna të cilat mund të shërbenin si indicie në drejtim të:

mësipërme, unë synoja të fusja në dy apartamentet që mbetën për t'u shitur, njerëz të njohur që do të kishin kujdes në përdorimin e tyre [...]”.

¹⁹ Në lidhje me kërkesën e Komisionit për të dhënë sqarime lidhur me shkakun e përdorimit nga vjehrra e subjektit të pasurisë nr. {***}, subjekti është përgjigjur: *“Vjehrra ime, zonja S. Sh., është grua e ve qysh prej vitit 2001. Ajo në mënyrë periodike dhe për periudha kohore shkon për të ndernjur pranë secilit prej fëmijëve. Koha e qëndrimit pranë tyre është në varësi të kushteve që ka gjithsecili. Duke qenë se unë kisha marrë në dorëzim apartamentet, kisha mundësinë për t'i ofruar asaj një qëndrim dhe përkujdesje. Nga ana tjetër, ishte në interesin tim për të pasur njerëz të afërm apo të njohur nëpër apartamentet që unë disponoja. Kjo pasi për disa vjet nga marrja në dorëzim, në to nuk banonte njeri dhe përbënin një barrë për mua shpenzimet për pastrimin, ajrosjen, mirëmbajtjen etj. [...]”.*

²⁰ Në drejtim të pyetjeve 4 dhe 5 të një pyetësori të Komisionit, të dërguar subjektit më datë 23.10.2018.

- (i) fshehjes nga ana e subjektit të rivlerësimit të të ardhurave nga shfrytëzimi i këtyre pasurive të paluajtshme; apo qoftë edhe
- (ii) për të ardhura të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si të fituara me burim qiradhënien e këtyre apartamenteve, personave të sipërcituar apo edhe të tretëve, dhe për të cilat nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore.
62. Për rrjedhojë të sa më sipër, duke pasur në konsideratë se (i) këto pasuri të paluajtshme në periudhën objekt kontrolli kanë qenë pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, janë përdorur lirisht prej tij brenda tagrave të tij si pronar i ligjshëm i tyre; (ii) disponimi i tyre në formën e huapërdorjes nuk bie në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të legjislacionit civil apo legjislacionit të posaçëm lidhur me deklarimin e pasurive dhe interesave privatë; (iii) marrëdhënia e krijuar me huapërdoruesit nuk rezultoi nga hetimi administrativ të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit, rast i cili do duhej të deklarohet rregullisht në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi; si dhe (iv) dyshime të tjera në drejtim të fshehjes së të ardhurave të krijuara nga përdorimi i këtyre pasurive në formën e qiramarrjes dhe jo huapërdorjes, jo vetëm nuk janë ngritur nga Komisioni, por nuk rezultuan as nga shqyrtimi i kryer në Kolegj i fashikullit të Komisionit, sikundër dhe nuk u konstatua asnjë e dhënë tjetër që mund të përbënte indicie në këtë drejtim. Përkundrazi, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit paralel me marrëdhënien e huapërdorjes me z. G., rezultoi të ketë pasur një marrëdhënie qiradhënieje²¹ të një tjetër pasurie të tij të paluajtshme, asaj në rr. “{***}”, Tiranë, me një vlerë të konsiderueshme qiraje mujore, prej 600 eurosh, për të cilën, nga aktet e administruara nga organet tatimore, subjekti rezultoi si një tatimpagues i rregullt, i cili paguan çdo muaj detyrimin përkatës të tatimit mbi të ardhurën nga qiraja, në vlerën prej 15% të çmimit të qirasë – trupi gjykues arriti në përfundimin se marrëdhëniet e huapërdorjes së pasurive të subjektit të rivlerësimit nuk përbëjnë bazë për konkluzione në drejtim të një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë, sikundër në mënyrë të gabuar ka arritur në konkluzion, në vendimin e tij, Komisioni.
63. Sa i takon çështjes së huapërdorjes së 1/3 së njërit prej garazheve në pronësi të subjektit të rivlerësimit nga ana e z. R. S., konstatohet se përfundimi i arritur nga ana e Komisionit nuk është në përputhje me barrën e provës që i është kaluar subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë që subjekti të rivlerësimit, me dokumentin e rezultateve të hetimit, i është kërkuar: *të vërë në dispozicion dokument që nuk vërtetohet konflikti i interesit me shtetasin R. S., si dhe të vërtetojë faktin që ai është administrator i pallatit* – konkluzioni i Komisionit në vendim fokusohet te vlerësimi lidhur me nevojën e subjektit për të vazhduar këtë marrëdhënie huapërdorjeje pas zhvendosjes së tij për

²¹ Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë Komisionit:

1. **Kontratë qiraje, lidhur më datë 23.02.2015**, me afat të caktuar 1 vit, nga data 05.03.2015 deri më 04.03.2016, me çmim qiraje 600 euro/muaj për apartamentin me sip. 105 m², në rrugën “{***}”, Tiranë.

2. **Kontratë qiraje, lidhur më datë 08.03.2016**, me afat të caktuar 1 vit, nga data 04.03.2016 deri më 03.03.2017, me çmim qiraje 600 euro/muaj për apartamentin me sip. 105 m², në rrugën “{***}”, Tiranë.

3. **Kontratë qiraje, lidhur më datë 05.12.2016**, me afat të caktuar 1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës, me çmim qiraje 550 euro/muaj për apartamentin me sip. 105 m², në rrugën “{***}”, Tiranë.

4. **Kontratë qiraje, lidhur më datë 20.10.2017**, me afat të caktuar 1 vit nga data 18.10.2017, me çmim qiraje 600 euro/muaj për apartamentin me sip. 105m², në rrugën “{***}”, Tiranë.

Lidhur me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas kontratave të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në deklarimet e tij periodike për vitet 2015, 2016, 2017 përkatësisht 5100 euro, 5568 euro dhe 735904 lekë, ndërsa pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse është konfirmuar gjatë hetimit administrativ sipas shkresës nr. prot. {***}, datë 22.08.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë drejtuar ILDKPKI-së dhe sipas shkresës nr. prot. {***}, datë 10.05.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë drejtuar Komisionit, nga ku rezultoi se subjekti ka derdhur rregullisht në buxhet tatimin mbi këtë të ardhur, përkatësisht në masën 124200 lekë për vitin 2015, 134825 lekë për vitin 2016, 118892 lekë për vitin 2017 dhe 47610 lekë për 4 muajt e parë të vitit 2018.

të banuar në {***} në vitin 2015, konkluzion ky dukshëm i mbështetur mbi një vlerësim subjektiv të rastit, dhe që nuk është rrjedhojë logjike e një procesi vlerësimi dhe analize të gjetjeve të rezultuara nga hetimi administrativ, si dhe të përmbushjes nga ana e subjektit të rivlerësimit të barrës së provës së kaluar për këtë qëllim. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në të njëjtin konkluzion si në rastin e dy huapërdorjeve të trajtuara në paragrafët pararendës, se kjo marrëdhënie huapërdorjeje e subjektit të rivlerësimit, me objekt pasurinë e paluajtshme në pronësi të tij, nuk përbën bazë për konkluzione në drejtim të një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli.

64. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj edhe këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe të padrejtë e të pabazuar konkluzionin e Komisionit për marrëdhënie të dyshimta huapërdorje, për sa kohë asnjë nga situatat e parashikuara në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, për të cilat përcaktohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, jo vetëm nuk ka rezultuar e provuar gjatë hetimit administrativ, por as dyshime të arsyeshme nuk janë ngritur në drejtim të sa më sipër.
65. *Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me kundërshtimin si të pabazuar dhe rrjedhojë të një vlerësimi subjektiv nga ana e Komisionit, të konstatimit të këtij të fundit në rubrikën “Vlerësimi tërësor i çështjes” në pjesën arsyetuese të vendimit, sipas të cilit ka thënie kontradiktore në lidhje me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit të dy prej pasurive në pronësi të tij, trupi gjykues vëren si më poshtë.*
66. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të dy prej pasurive në pronësi të tij, konkretisht apartamentit të banimit në rrugën “{***}”, në Tiranë dhe një prej apartamenteve në {***}, Tiranë (apartamenti në të cilin banon dhe aktualisht) se nga informacioni i OSHEE-së për shpenzimet e energjisë elektrike, por dhe nga shpjegimet e subjektit, i ka rezultuar që për periudhën korrik 2013 - dhjetor 2014, subjekti të ketë banuar njëkohësisht në dy apartamente, gjë që sipas Komisionit është praktikisht e pamundur. Komisioni është shprehur se këto fakte e bëjnë të dyshimtë përdorimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të apartamentit të banimit në {***} për periudhën korrik 2013 - dhjetor 2014, duke arritur në përfundimin se thëniet kontradiktore të subjektit në lidhje me përdorimin e dy prej pasurive të arsyetuara në vendimin e tij, vlerësohen si një ndër faktet, bazuar në të cilat Komisioni, në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, ka arritur në konkluzionin përfundimtar se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
67. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të konstatimit të Komisionit mbi thëniet kontradiktore në lidhje me përdorimin prej tij të dy pasurive të sipërcituara në pronësi të tij, ka pretenduar në ankimin e tij, sa më poshtë.
 - 67.1. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konstatimin e Komisionit lidhur me thëniet kontradiktore. Ai është shprehur se prej tij janë dhënë vetëm një herë shpjegime në lidhje me përdorimin e banesave në pronësi të tij, përkatësisht banesës në rrugën “{***}” dhe të një apartamenti në {***}, si dhe në shpjegimet e dhëna në mënyrë të qartë dhe jokontradiktore ka sqaruar se apartamenti në {***}, ku dhe banon aktualisht, ka qenë në vijimësi në përdorimin e tij.

67.2. Konkluzioni i Komisionit se është “praktikisht e pamundur” që familja e subjektit të rivlerësimit të ketë përdorur njëkohësisht dy apartamente për një periudhë kohe, sipas subjektit të rivlerësimit është një konkluzion subjektiv dhe i pambështetur.

- 68.** Në vlerësim të këtij shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues pasi mori në shqyrtim pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe analizoi aktet e fashikullit lidhur me hetimin e kryer nga Komisioni në këtë drejtim, konstatoi si më poshtë.
- a) Subjekti i rivlerësimit, lidhur me pyetjen 1 të pyetësorit standard: “A keni jetuar në adresën që është shënuar në zyrat e gjendjes civile apo në atë që keni shënuar në vetëdeklarim në shtatë vitet e fundit (respektivisht 2011-2017)?” – është përgjigjur: *Deri në vitin 2015 kam banuar në adresën e shënuar në zyrat e gjendjes civile, rr. “{***}”, P. {***}, Ap. {***}, Tiranë. Pas kësaj date e në vijim, banoj në adresën rr. “{***}”, komuna {***}, Tiranë.*
- b) Në shpjegimet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit lidhur me gjetjet e Komisionit në raport me përdorimin e apartamentit të tij të banimit në {***}, si dhe në përmbushje të barrës së provës për të vërtetuar me dokumente shkresore se si dhe nga kush është përdorur ky apartament banimi që nga viti 2010 deri në dhjetor 2014, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Apartamenti në {***} ku unë banoj aktualisht, ka qenë në vijimësi në përdorimin tim. Qysh nga viti 2009 e deri në vitin 2013 në të nuk është banuar, por herë pas here unë kam shkuar dhe kam bërë punime përmirësimi e arredimi të ambienteve të kësaj banese. Nga korriku 2013 deri në dhjetor 2014, ka qenë një periudhë transitore ku nga familja janë përdorur të dy apartamentet në përgatitje për t’u transferuar përfundimisht në banesën ku unë banoj aktualisht. Kjo u ndikua nga fakti se për të përgatitur për transferimin përfundimtar, banesa ku banoj aktualisht kërkonte prezencën tonë të shpeshtë për rregullimet dhe arredimet përfundimtare. Nga ana tjetër, banesa ku unë aktualisht banoj, ishte në një zonë që ishte në ndërtim e sipër dhe jo me të gjitha shërbimet sociale. Edhe fakti që shkollat e dy fëmijëve më të rritur, M. dhe A. (Fakulteti {***} dhe shkolla “{***}”) ishin pranë banesës në rr. “{***}”, në Tiranë, bëri që në këtë periudhë të përdoreshin të dy apartamentet. Kjo dhe për faktin se nuk kishim ndonjë nevojë urgjente për t’u zhvendosur. Dëshiroj të saktësoj edhe deklarin tim në përgjigje të pyetësorit se “nga viti 2015 e aktualisht banoj në adresën rr. “{***}”, Pall. {***}, Komuna {***}”. Kjo nënkupton se nga ky moment unë kam filluar të banoj efektivisht dhe ekskluzivisht në atë adresë. Pra, koha e deklaruar nga ana ime në përgjigje të pyetësorit, përfaqëson kohën kur e tërë familja u zhvendos përfundimisht nga apartamenti në rr. “{***}” në apartamentin ku unë aktualisht banoj, pra përfaqëson momentin formal.*
- 69.** Në vlerësim të deklarimeve të sipërcituara të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se nuk është përpara rastit të deklarimeve kontradiktore, për sa kohë përgjigjet e subjektit të rivlerësimit u referoheshin pyetjeve të Komisionit, në fokus të të cilit ka qenë nevoja për të qartësuar dy momente konceptualisht jo të njëjta. Më konkretisht, ndërkohë që sipas pyetjes së parë subjekti i rivlerësimit është pyetur se ku ka banuar/jetuar gjatë viteve 2011-2017, në pyetjen e dytë është pyetur se nga kush është përdorur njëri prej apartamenteve në pronësi të tij, për periudhën korrik 2013 - dhjetor 2014. Përgjigjja e subjektit për përdorim të apartamentit në {***} në periudhën korrik 2013 - dhjetor 2014, prej tij, në kuadër të përgatitjes për t’u zhvendosur për të jetuar përfundimisht në këtë apartament, në vlerësimin e trupit gjykues nuk bie në kundërshtim me përgjigjen e tij në kuadër të pyetësorit të parë, se deri në vitin 2015 “kam banuar në adresën e shënuar në zyrat e gjendjes civile”. Sa i takon arsyetimit të Komisionit në vendim se është praktikisht e pamundur që subjekti të ketë banuar njëkohësisht në dy apartamente, trupi gjykues vlerësoi se ky arsyetim mund të ishte bindës në një interpretim logjik të fakteve, në rastin e një individi të vetëm, por jo të një familjeje prej pesë anëtarësh, ku për më tepër në atë periudhë

kohore, tre prej tyre, subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij edhe fëmija i parë i tyre, ishin persona madhorë.

70. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër trajtuar, trupi gjykues arriti në përfundimin se, për sa kohë të dyja këto apartamente janë pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, objekt deklarimi dhe kontrolli në kuadër të procesit të rivlerësimit, nga i cili nuk ka rezultuar që gjatë periudhës objekt gjykimi (korrik 2013 - dhjetor 2014) të jenë përdorur nga subjekti i rivlerësimit për qëllime fitimi duke krijuar të ardhura, të cilat nuk përmbushin standardet e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe këto të ardhura të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tjera të subjektit të rivlerësimit (rast për të cilin subjekti të rivlerësimit do t'i atribuoheshin pasojat e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurive të tij), çdo konkluzion tjetër, në drejtim të përdorimit të këtyre dy pasurive të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të ngrihet në nivelin e një konkluzioni me efekt negativ në rezultatin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit lidhur me kundërthënie në përdorimin e dy prej pasurive të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet nga trupi gjykues pa efekt në vlerësimin e kriterit të pasurisë së tij.
71. *Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e arritur nga Komisioni, se si pasojë e ndërtimit në mënyrë të paligjshme në vitin 1996 dhe mosdeklarimit në vitin 2003, të objektit me sipërfaqe 36 m² në {***}, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues konstatoi sa vijon.*
72. Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me ndërtimin nga subjekti i rivlerësimit të objektit me sip. 36 m² dhe mosdeklarimin e tij në vitin 2003, si më poshtë.
*Nga të gjitha faktet dhe rrethanat si më sipër, pavarësisht pretendimeve të subjektit se ndërtimi i objektit është bërë pas marrëveshjes verbale me shtetasin F. A., Komisioni vlerëson se, në kushtet kur u vërtetua se ky shtetas nuk ka pasur titull pronësie dhe as një AMTP në formën e kërkuar nga ligji (AMTP e vitit 1992, rezulton të jetë plot fshirje e korigjime, për t'u konsideruar e rregullt nga pikëpamja e një dokumenti shkresor ligjor), marrëveshja verbale me shtetasin F. A. në vitin 1996, nuk e legjitimonte subjektin të investonte mbi tokën me sip. 830 m², qoftë edhe në një objekt provizor, ku ka banuar për disa vite, nga e cila më pas ka përfutur tetë pasuri të paluajtshme.
Në këto kushte, faktet e vërtetuara, se subjekti ka ndërtuar në vitin 1996 në mënyrë të paligjshme një objekt, mbi një tokë që nuk ka qenë në pronësinë e tij, por as në pronësinë legjitime të z. F. A., duke vijuar me kërkesën e vitit 2005 për legalizim të këtij objekti, vetëm me qëllim kthimin e tokës bujqësore në truall, për efekt të ndërtimit të një objekti të përhershëm mbi të, janë fakte të cilat tregojnë veprime me qëllim përfitimi nga ana e subjektit, prandaj dhe mosdeklarimi i objektit prej 36 m², nuk duhet konsideruar thjesht si pasaktësi në deklarimin periodik për vitin 2003.
Në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni krijoi bindjen se shkak i mosdeklarimit të objektit me sip. 36 m², në {***}, Tiranë, në deklaratën periodike për vitin 2003, ka qenë pikërisht fakti se ky objekt ka qenë një ndërtim informal, dhe se, në tërësinë e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit, kjo pasaktësi duhet të merret në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, si provë me të njëjtën rëndësi sa dhe deklaratimet e pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën vetting, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
Në përfundim, lidhur me objektin provizor me sip. prej 36 m² në {***}, Tiranë, Komisioni ka arritur në përfundimin se veprimet dhe mosveprimet e subjektit në lidhje me këtë objekt vijnë në kundërshtim me etikën e një prokurori të Prokurorisë së Përgjithshme dhe cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

73. Subjekti i rivlerësimit shkakun e ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me vlerësimin e ndërtimit provizor me sip. 36 m² në {***}, e ka bazuar në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.
- (i) Sipas subjektit të rivlerësimit, objekti i sipërpërmendur ishte një ngrehinë e ndërtuar në kushtet e nevojës ekstreme për strehimin e familjes së tij të përbërë nga ai, bashkëshortja dhe vajza e sapolindur dhe se ky objekt nuk arrinte standardet e një banese të mirëfilltë, por “më tepër ishte një barakë”, një dhomë dhe një banjë që lidheshin me një korridor, e gjitha me sipërfaqe 36 m², e ndërtuar me blloqe të ricikluara, pa themele, pa pllaka, shtruar me çimento, banja e mbuluar me letër katrama etj., kurse kushtet e jetesës në të nuk arrinin as në nivelin e jetesës së një njeriu të zakonshëm dhe jo më të një zyrtari të lartë të shtetit, si prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, ndërtimi i kësaj strehe provizore, me mungesë të parametrave teknikë, e diktuar nga nevoja ekstreme, si dhe kushtet në të cilat ka jetuar ai së bashku me familjen e tij, nuk kishin mundësi të cenonin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, përkundrazi. Në mbështetje të këtyre argumenteve, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave të reja “Aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 1997 të Prokurorisë Tiranë”, nëpërmjet të cilave kërkoi të provojë standardin e objektit të ndërtuar në {***}, në të cilin ka jetuar në vitet 1996-2000, në periudhën para marrjes së kredisë së butë, si dhe nivelin e sigurisë në këtë zonë, fakte të pretenduara këto edhe gjatë seancës dëgjimore në Komision.
- (ii) Subjekti pretendoi se mosdeklarimi i këtij ndërtimi në deklaratën periodike të vitit 2003, ka qenë rrjedhojë e paqartësisë nëse një ndërtim i tillë provizor, me mungesë të parametrave teknikë për t’u quajtur banesë dhe i destinuar për t’u prishur, do të përbënte pasuri të deklarueshme, shtuar fakti që ky ishte viti i parë i deklarimit pas hyrjes në fuqi të ligjit përkatës dhe i pashoqëruar me shpjegime të detajuara mbi atë që do duhej të deklarohet. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo ngrehinë nuk është mbajtur e fshehtë ndaj autoritetit kontrollues, pasi ajo në mënyrë *incidentale* është deklaruar në deklaratat e viteve 2006, 2007 dhe 2008 në kuadër të deklarimit të së ardhurës së përfituar në formën e një kompensimi mujor nga shoqëria {***} ShPK, me rastin e prishjes së saj për të ndërtuar objektin shumëkatësh.
74. Në vlerësim të këtij shkakun të ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili në themel të tij ka pretendimin për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me vlerësimin e ndërtimit në mënyrë të paligjshme të objektit me sip. 36 m² dhe mosdeklarimit të tij në deklaratën për herë të parë në vitin 2003, si shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues konstatoi fillimisht se, referuar dokumentit mbi rezultatet e hetimit, Komisioni thjesht ka konstatuar faktin e ndërtimit të këtij objekti me sip. 36 m², në {***}, në vitin 1996, në tokën për të cilën subjekti ende nuk kishte fituar titullin e pronësisë, si dhe faktin se ky ndërtim, për të cilin është aplikuar për legalizim në vitin 2005, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën për herë të parë në vitin 2003.
75. Nga shqyrtimi i kujdesshëm i dokumentit të rezultateve të hetimit, nuk rezultoi që mbi këto fakte të konstatuara si të provuara nga Komisioni gjatë hetimit të tij, të jetë bërë një kualifikim i caktuar ligjor, sipas të cilit mbi subjektin e rivlerësimit mund të rëndonin pasoja të caktuara juridike në kuadër të procesit të rivlerësimit, në rast se ai nuk do arrinte të përmbushte barrën e provës së kaluar, në mënyrë të qartë dhe të shprehur nga Komisioni, për të provuar të kundërtën e sa më sipër kualifikuar prej tij. Në kuptim të sa më sipër, në parim trupi gjykues çmoi se konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me objektin prej 36 m², në {***}, si veprime në kundërshtim me etikën e një prokurori që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, është arritur në saje të një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-

së, pasi subjektit të rivlerësimit nuk i është dhënë e drejta të dëgjohet dhe të mbrohet gjatë procesit të zhvilluar në Komision, lidhur me këtë kualifikim ligjor të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ.

76. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit mbi bazueshmërinë në fakte dhe në ligj të vendimit të Komisionit, lidhur me çështjen objekt kontrolli, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të krijuar nga hetimi në Komision, vlerësuar këto në raport me parashikimet ligjore në fuqi në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi sa më poshtë.

a) Subjekti i rivlerësimit, në maj të vitit 1996²², ka ndërtuar objektin me sip. 36 m² mbi tokën arë me sip. 830 m², pjesë përbërëse e pasurisë me nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me vendndodhje në {***}, Tiranë, regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, në pronësi të z. F. S. A., më datë 25.12.1996, sipas AMTP-së me nr. {***}, datë 01.08.1992. Toka mbi të cilën është ndërtuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ka kaluar në pronësi të tij me “Kontratën e shitjes së tokës arë”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2000, para noteres B. H., regjistruar në ZVRPP Tiranë në të njëjtën datë. Për rrjedhojë, ky objekt prezumohet se është ndërtuar në tokën e z. A. në vitin 1996, me miratimin e këtij të fundit, në cilësinë e pronarit të ligjshëm të tokës, çka në vlerësim të trupit gjykues provon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka poseduar tokën në të cilën ka ndërtuar objektin me sip. 36 m², nëpërmjet pushtimit, në cenim të së drejtës themelore të pronës së z. F. A.

b) Referuar parashikimeve të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, konkretisht nenit 30 të tij, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kërkuar dhe të ishte pajisur me leje ndërtimi qoftë në rastin e një ndërtimi të ri (me karakter të përhershëm), qoftë për një ndërtim provizor, të përkohshëm, si ky në rastin objekt gjykimi. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ndërtimi i këtij objekti me sip. 36 m² nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 1996, është kryer në kundërshtim me legjislacionin e kohës për urbanistikën.

77. Në vlerësim të çështjes nëse ky veprim i subjektit të rivlerësimit – mosrespektimi i kuadrit ligjor në fushën e ndërtimit – arrin të cenojë apo jo besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në të cilat ato kanë ndodhur, çmoi të nevojshme të mbajë në konsideratë:

(i) Kohën e largët në të cilën është kryer veprimi në kundërshtim me ligjin, si dhe marrëdhënien e subjektit me ligjin për periudhën në vazhdim, për të cilën nuk rezultoi asnjë provë apo qoftë edhe ndonjë e dhënë që mund të shërbente si indicie në drejtim të sjelljes së papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit në raport me ligjin, gjatë ushtrimit të funksionit të tij apo edhe jashtë tij. Në funksion të sa më sipër, u vlerësua si tregues në favor të një sjelljeje korrekte edhe mungesa e denoncimeve të publikut ndaj subjektit të rivlerësimit, jo vetëm në kuadër të procesit të rivlerësimit, por më gjerë, gjatë gjithë periudhës së karrierës së tij si prokuror, referuar të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, prej nga rezultoi se nuk ka të dhëna të cilat kanë të bëjnë me ankesa të regjistruara ndaj subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça.

(ii) Madhësinë e objektit të ndërtuar, prej 36m² (një dhomë dhe një banjo, të lidhura me një korridor), i cili përmbushte vetëm nevojën bazike të subjektit të rivlerësimit për të pasur një strehë për veten, bashkëshorten dhe fëmijën e sapolindur, çka u vlerësua nga trupi gjykues si e dhënë në drejtim të vërtetësisë së qëllimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, se ndërtimi i objektit prej 36 m² ishte diktuar nga nevoja ekstreme për strehim.

(iii) Kushtet tejet modeste të jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij në objektin e ndërtuar në {***}, të cilat u konstatuan nga provat fotografike, të përcjella nga subjekti i

²² Referuar formularit të vetëdeklarimit të subjektit të rivlerësimit pranë ALUIZNIT.

rivlerësimit gjatë hetimit në Komision (duke bërë të panevojshme, për pasojë, marrjen e provave të reja në këtë drejtim, të përcjella së bashku me ankimin), kushte këto të cilat u morën në konsideratë në drejtim të vlerësimit sa më të drejtë të çështjes dhe arritjes në konkluzionin se për trupin gjykues ky veprim, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fushën e ndërtimeve, nuk ka mundur të cenojë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, porse ai sjell dëshminë për figurën e një funksionari të drejtësisë në kushte të mjerueshme jetese, provë e faktit të pretenduar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit se ka vuajtur gjatë periudhës 10-vjeçare të karrierës së tij problematika lidhur me strehimin, gjë që mund të mos kishte ndodhur nëse ai do kishte abuzuar me detyrën dhe funksionin e tij për qëllime përfitimi personal, duke cenuar në mënyrë thelbësore vlerat themelore të një funksionari të drejtësisë, si dhe besimin e publikut në ushtrimin prej tij të funksioneve publike, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

(iv) Faktin që, në kohën kur subjekti ka ndërtuar në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm në fushën e ndërtimit objektin me sip. 36 m² (viti 1996), ky veprim nuk parashikohej nga legjislacioni i kohës si vepër penale²³.

78. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin që Komisioni nuk ka vlerësuar në mënyrë objektive faktet e provuara gjatë hetimit administrativ lidhur me ndërtimin e objektit me sip. 36 m², rrethanat në të cilat është kryer veprimi në kundërshtim me ligjin, shkaqet që e kanë diktuar atë, periudhën e largët në të cilën ka ndodhur ky fakt dhe, mbi të gjitha, mungesën e një kuadri të brendshëm rregullator apo dhe ndërkombëtar²⁴ në drejtim të standardeve të zbatueshme të etikës së këtyre funksionarëve të drejtësisë, të cilat shërbejnë si bazë për vlerësimin e sjelljeve të cilat cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, në mënyrë të gabuar dhe në shkelje edhe të parimit të proporcionalitetit, Komisioni ka arritur në përfundimin se ndërtimi në vitin 1996 i objektit provizor me sip. 36 m², i cili është shembur në vijim në vitin 2006, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
79. Sa i takon çështjes tjetër për shqyrtim nga trupi gjykues, konkretisht detyrimit për deklaram të objektit me sip. 36 m² në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, trupi gjykues konstatoi se referuar legjislacionit të zbatueshëm²⁵, subjekti i rivlerësimit kishte detyrim ligjor të deklaronte të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre. Sipas përshkrimit në Formularin A-1, në faqen 4 të deklaratës Model 5.1, koncepti i pasurisë së paluajtshme (në përputhje dhe me parashikimin e nenit 142 të Kodit Civil), të deklarueshme, përkufizohet si: *Toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat (dyqane, shtëpi banimi, magazina, fabrika, uzina, pikë karburanti, etj.), ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.*
80. Në kuadër të sa më sipër, u pa e nevojshme që vlerësimi mbi ekzistencën e detyrimit për deklaram të bazohet në vlerësimin nëse natyra e ndërtimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit, ndërtim pa themele dhe në mungesë të kushteve teknike, përbënte apo jo një ndërtesë në kuptimin që i jep legjislacioni i zbatueshëm, apo së paku një send të trupëzuar në mënyrë të

²³ Ndërtimi i paligjshëm është parashikuar si vepër penale me ndryshimet e Kodit Penal të miratuara me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 15.01.2009.

²⁴ Vlen të përmendet që edhe iniciativa ndërkombëtare për përcaktimin e parimeve të përgjithshme në kuadër të garantimit dhe forcimit të integritetit të sistemit gjyqësor, ka nisur në vitin 2000, për t'u konkretizuar me miratimin e të ashtuquajturës "Parimet e Bangladorës", nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, në vitin 2003. Ndërsa Udhëzuesi Evropian mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë ("The Budapest Guideline") është miratuar në vitin 2005 nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm, e organizuar nga Këshilli i Evropës.

²⁵ Shih ish-nenin 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokën, për t'u vlerësuar si pasuri e paluajtshme, objekt deklarimi sipas parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

81. Referuar ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, në nenin 3 të tij përcaktohet shprehimisht: *Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe, punime ndërtimi quhen të gjitha punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale, të infrastrukturës dhe për objektet e tjera. Në nenin 4 të të njëjtit ligj, sa u takon kërkesave themelore lidhur me punimet në ndërtim, parashikohet: Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:*
- (i) rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;
 - (ii) sigurinë nga zjarri;
 - (iii) higjienën, shëndetin dhe mjedisin;
 - (iv) sigurinë në përdorim;
 - (v) mbrojtjen nga zhurmat;
 - (vi) kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.
82. Ndërkohë, sipas nenit 13 të ligjit të sipërcituar: *Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni ose zyra e urbanistikës, pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit. Me kërkesën e zotëruesit të sheshit të ndërtimit, seksioni a zyra përkatëse urbanistike i dërgon zyrtarisht zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti, konfirmimin zyrtar të përfundimit të punimeve të ndërtimit të objektit në përputhje me ligjin, projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit. [...] Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë së të interesuarit.*
83. Në analizë të parashikimeve të mësipërme ligjore, trupi gjykues arriti në përfundimin se objekti provizor i ndërtuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 1996, pa themele dhe i mbështetur në avllinë e komshiut, për të cilin nuk plotësohet kriteri i trupëzimit të tij me tokën, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, sikundër dhe as kërkesat themelore të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, nuk mund të vlerësohet si pasuri e paluajtshme në kuptim të përkufizimit të dhënë në Kodin Civil, huazuar ky përkufizim dhe në shpjegimet mbi pasurinë e paluajtshme objekt deklarimi, sipas dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
84. Trupi gjykues vlerësoi se, në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, ky “ndërtim” do të përbënte detyrim për deklarim nga subjekti i rivlerësimit, në rastet e mëposhtme.
- (i) Në formën e pasurisë së paluajtshme, në momentin e legalizimit të ndërtimit informal, situatë kjo për të cilën nuk i ka lindur ndonjë detyrim subjektiv të rivlerësimit duke qenë se objekti në fjalë është shembur në vitin 2006 dhe objekti nuk rezultoi të ishte legalizuar më parë.
 - (ii) Në formën e shpenzimit të deklarueshëm, si tërësi e vlerës monetare të shpenzuar për investimin e kryer për ndërtimin e objektit, detyrim i cili është vendosur me ligjin nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, i ndryshuar, për shpenzimet me vlerë mbi 500000 lekë gjatë vitit të deklarimit, dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Subjekti i rivlerësimit, referuar kohës në të cilën është kryer ky shpenzim prej tij, në vitin 1996, nuk ndodhej as në kushtet e detyrimit ligjor për një deklarim të tillë.

(iii) Në formën e një interesi privat që ka buruar nga ndërtimi i objektit në tokën në pronësi të personave të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit, rast ky i cili nuk ishte i zbatueshëm në vitin 2005, kur lindi detyrimi ligjor për deklarimin e këtyre interesave privatë sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, duke qenë se në vitin 2000 subjekti i rivlerësimit kishte fituar pronësinë e tokës mbi të cilën ishte ndërtuar objekti provizor me sip. 36 m².

85. Në kuptim të sa më sipër, referuar kërkesave ligjore të legjislacionit të kohës, subjekti i rivlerësimit u vlerësua nga trupi gjykues se nuk ka qenë në kushtet e detyrimit për deklarim të këtij objekti në vitin 2003, dhe as në periudhën në vazhdim deri në vitin 2006, vit në të cilin ky objekt është shembur. Në çdo rast, në kuadër të kontrollit të pasurisë së subjektit në proces rivlerësimi, posedimi i këtij objekti të ndërtuar në vitin 1996, ndikon në procesin e rivlerësimit vetëm sa i takon analizës së mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar investimin në fjalë, moment ky për të cilin nuk rezulton të ketë pasur ndonjë gjetje nga Komisioni në disfavor të subjektit të rivlerësimit.
86. Ky objekt i shembur në vitin 2006, me fillimin e punimeve nga shoqëria “{***}” ShPK për ndërtimin e godinës shumëkatëshe mbi tokën me sip. 830 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ka krijuar për vitet 2006, 2007 dhe 2008 të ardhura, përkatësisht vlerat prej 150.000 lekësh për vitin 2006 dhe nga 180.000 lekë për dy vitet e tjera, si pagesë në formën e një kompensimi mujor për prishjen e objektit, në vlerën prej 15.000 lekësh, parashikuar si detyrim i shoqërisë ndërtuese në kontratën e shkëmbimit të lidhur me këtë të fundit. Këto vlera monetare nuk rezultojnë të jenë deklaruar si burim për krijimin e ndonjë pasurie në vazhdim nga ana e subjektit të rivlerësimit.
87. Në përfundim të sa më sipër analizuar, trupi gjykues arriti në përfundimin se, referuar kuadrit ligjor të kohës në të cilën u mor në analizë detyrimi për deklarim, si pasojë e natyrës së objektit të ndërtuar dhe rrethanave të këtij rasti konkret, subjekti nuk ka qenë në kushtet e detyrimit për deklarimin e objektit në kuptim të detyrimit për të deklaruar një pasuri të paluajtshme të akumuluar deri në vitin 2003. Për më tepër, edhe në rast të ekzistencës së këtij detyrimi, trupi gjykues çmoi se mosdeklarimi i tij, në kuadër të procesit të rivlerësimit, nuk arrin të prodhojë pasojën e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë kjo nuk është një pasuri ekzistuese e subjektit të rivlerësimit, si dhe ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, pasuritë e fituara nga kontrata e shkëmbimit nuk kanë burim objektin provizor të shembur në vitin 2006, por pasurinë e paluajtshme tokë arë me sip. 830 m², të deklaruar rregullisht si pasuri e paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të kontrolluar përkatësisht nga organet e rivlerësimit.
88. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit të drejtë dhe të bazuar dhe, për rrjedhojë, vlerëson të cenueshëm konkluzionin e arritur nga Komisioni në vlerësimin që ai i ka bërë objektit me sip. 36 m², dikur në posedim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues çmoi se në kushtet kur konkluzioni i Komisionit për cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit lidhur me objektin me sip. 36 m², u gjet i padrejtë dhe i pabazuar, korrigjimi i shkeljes së konstatuar për cenim të procesit të rregullt në lidhje me të drejtën e subjektit për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, në kuptim të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, u vlerësua i panevojshëm.
89. *Në lidhje me shkakun e ankimit për konkluzion të pabazuar në ligj, në prova dhe rrjedhojë e zbatimit të standardeve të dyfishta nga ana e Komisionit, sa i takon vlerësimin të tij lidhur me*

*pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me sip. 92,45 m², ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, në {***}, Sarandë, trupi gjykues vëren si vijon.*

90. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me mosdeklarimin e faktit të bashkëpronësisë së subjektit të rivlerësimit në ¼ pjesë mbi këtë pasuri të paluajtshme: [...] në lidhje me mosdeklarimin e pronësisë mbi 1/4 pjesë të pandarë në pasurinë apartament banimi në {***}, pavarësisht pretendimit të subjektit se nuk ka qenë në dijeni në vitin 2004 (kur është plotësuar deklarata për vitin 2003) mbi këtë bashkëpronësi, si dhe pavarësisht nga fakti se ai ka hequr dorë nga e drejta e pronësisë me deklaratën noteriale të vitit 2011, Komisioni çmon se në momentin e plotësimit të deklaratës periodike për vitin 2003, dhe aq më shumë në momentin e plotësimit të deklaratës "vetting", subjekti ka pasur detyrim për verifikimin e çdo lloj pasurie në pronësi të tij (qoftë dhe de jure), me qëllim plotësimin e kësaj deklarate me vërtetësi dhe saktësi, sipas parashikimit të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. [...] Në këto kushte, konstatohet se deklaratimet për vitin 2003 dhe atë "vetting" janë të pasakta, edhe pse mosdeklarimi i 1/4 pjesë të pasurisë në {***}, në vetvete nuk ka qenë me qëllim fshehjen e kësaj pasurie. Por, Komisioni çmon që ta konsiderojë këtë pasaktësi në harmoni me provat e tjera, gjatë procesit të vendimmarrjes. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni e ka vlerësuar konkluzionin e arritur lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, si shkak për arritjen në konkluzionin përfundimtar lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë, sipas të cilit subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për këtë kriter, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
91. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim lidhur me kundërshtimin e vlerësimit që Komisioni i ka bërë mosdeklarimit të bashkëpronësisë së tij në ¼ pjesë të pasurisë së sipërcituar, ka parashtruar pretendimet e mëposhtme në ankimin e tij.
- 91.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kohën e plotësimit të deklaratës për herë të parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, ai nuk ka qenë në dijeni të faktit se ishte bashkëpronar me ¼ pjesë të pasurisë së paluajtshme në të cilën jetonin prindërit e tij në qytetin e {***}. Subjekti pretendoi se deri në vitin 2011 ai ka qenë në dijeni të privatizimit të banesës në të cilën jetonin prindërit e tij, por jo të kohës në të cilën është kryer privatizimi dhe as të faktit se, për shkak se në momentin e privatizimit, gjendja e tij civile ishte në qytetin e {***}, ai ishte bërë bashkëpronar me ¼ pjesë, fakt ky i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, i është bërë i ditur prej prindërve të tij në vitin 2011.
- 91.2. Sa i takon mosdeklarimit të bashkëpronësisë me ¼ pjesë të apartamentit të prindërve në {***}, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke qenë se në vitin 2011 ai ka hequr dorë nga bashkëpronësia e tij mbi këtë pasuri të paluajtshme, duke ia kaluar këto të drejta nënës së tij, nëpërmjet një deklarate noteriale.
- 91.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me efektin e mosdeklarimit të pasurisë së sipërcituar në procesin e rivlerësimit, është i pabazuar në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe qëndrimi i Komisionit lidhur me këtë çështje në rastin e tij përbën standard të dyfishtë në raport me qëndrimin e mbajtur në çështje të tjera lidhur me situata të ngjashme faktike.
92. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ankimit lidhur me këtë pasuri dhe në vijim të arsyetimit të Komisionit si më sipër, trupi gjykues i pranoi si bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të arsyes për mosdeklarim të bashkëpronësisë në ¼ pjesë të kësaj pasurie të paluajtshme, në momentin e deklarimit për herë të

parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2004. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit është larguar nga banesa prindërore në {***} që në vitin 1989, si pasojë e ushtrimit të detyrës si prokuror në qytetin e Korçës ku dhe ka jetuar deri në vitin 1994, kur është transferuar në qytetin e Tiranës. Largimi nga banesa prindërore dhe shkëputja e lidhjeve me këtë pasuri të paluajtshme shumë përpara momentit të privatizimit të saj, krijoi bindjen te trupi gjykues se mungesa e vëmendjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të përfshirjes së tij në rrethin e personave që përfitonin nga privatizimi i kësaj banese, për shkak të parashikimeve ligjore të kohës, është e justifikueshme.

93. Ndërsa sa i takon çështjes së deklaramit të bashkëpronësisë mbi këtë pasuri të paluajtshme në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues vlerësoi të marrë në analizë faktin nëse në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit kishte apo jo detyrimin për të deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri të paluajtshme, analizë kjo e cila u fokusua në vlerësimin e faktit nëse, me nënshkrimin e deklaratës noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 02.08.2011, pranë noterit A. A., për heqjen dorë nga e drejta e bashkëpronësisë në ¼ pjesë të pasurisë së paluajtshme në fjalë, subjekti i rivlerësimit nuk ishte më pronar i saj *de jure*, edhe pse figuronte si i tillë në regjistrin e pasurive të paluajtshme në momentin e verifikimit të kryer nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit.
94. Në analizë të kuadrit të zbatueshëm ligjor, trupi gjykues vlerësoi se referuar parashikimeve të neneve 191 dhe 83 të Kodit Civil, me nënshkrimin e aktit noterial për heqje dorë nga e drejta e pronësisë mbi pjesën takuese dhe kalimin e kësaj pjese pa shpërblim nënës së tij, znj. M. K., subjekti i rivlerësimit ka humbur këtë të drejtë nga momenti i nënshkrimit të kësaj deklaratë noteriale. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion në saje të interpretimit të dispozitave të sipërcituara të Kodit Civil, në dritën e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1/2009, sipas të cilit mosregjistrimi i veprimit juridik lidhur me kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme, nuk e bën veprimin juridik të pavlefshëm, por nuk i jep përfituesit të pasurisë të drejtën ta tjetërsojë atë te të tretët. Sipas këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pronësia mbi sendet e paluajtshme kalon në momentin e kryerjes së veprimit juridik dhe jo pas regjistrimit të tij në regjistrin e pasurive të paluajtshme, veprim ky i cili vlerësohet me efekt deklarativ dhe jo si akt i cili krijon apo shuan të drejta pronësie te palët e përfshira në transaksion. Për më tepër, trupi gjykues në drejtim të vlerësimit të kujdesit të treguar nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë transaksion, mbajti në konsideratë edhe dispozitat e zbatueshme të legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, ku referuar nenit 38 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, detyrimin për regjistrim të të drejtave të pronësisë e ka mbajtësi i titullit të pronësisë dhe regjistrimin e realizon nëpërmjet një kërkese pranë organit kompetent për regjistrimin e aktit me të cilin i kanë kaluar të drejtat e pronësisë. Referuar së njëjtës dispozitë ligjore, detyrim për paraqitjen e kopjes së vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme ose të një të drejte reale mbi atë, ose deklaramin të pavlefshme të veprimeve juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, e kanë, ndër të tjerë, edhe noterët. Trupi gjykues nuk konstatoi që subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e titullarit të mëparshëm të të drejtave të bashkëpronësisë, në lidhje me pasurinë në fjalë, të ketë pasur ndonjë detyrim ligjor në raport me procedurën e regjistrimit të aktit të heqjes dorë nga të drejtat e pronësisë, të cilin të mos e ketë përmbushur. Mbi të gjitha, trupi gjykues vlerësoi me një rëndësi të posaçme, në këtë rast, faktin që vullneti i subjektit për heqjen dorë nga bashkëpronësia në ¼ pjesë të pasurisë së paluajtshme “apartament banimi”, në të cilin jetojnë prindërit e tij në {***}, daton që në vitin 2011, fakt i cili dëshmon një akt vullneti të lirë të subjektit të rivlerësimit për të disponuar mbi të

drejtat e tij të bashkëpronësisë, i pandikuar dhe i zhveshur nga qëllime të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit kalimtar dhe rezultatin e vlerësimit të kriterit të pasurisë.

95. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, për sa kohë ka vërtetuar se ka humbur të drejtat e bashkëpronësisë mbi pasurinë e paluajtshme si më sipër cituar, nuk ka pasur detyrim për deklarimin e saj në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe, për rrjedhojë, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, nuk është në kushtet e deklarimit të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, edhe pse në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk figuron i regjistruar akti noterial i vitit 2011. Ky konkluzion do të binte nëse Komisioni do të kishte gjetje në drejtim të revokimit të këtij akti noterial, gjë e cila nuk rezultoi nga hetimi i kryer në Komision.
96. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit për mosdeklarim në deklaratën për herë të parë në vitin 2003 të të ardhurave të krijuara në vitin 2001 nga shitja e pasurisë së paluajtshme të privatizuar në Korçë, në shumën prej 1.250.000 lekësh, dhe deklarim të rremë të kësaj të ardhure në deklaratën e pasurisë (vetting) si të gabuar, të pabazuar në ligj dhe në prova dhe, mbi të gjitha, si konkluzione të arritura në mungesë të veprimeve hetimore në drejtim të sa më sipër, dhe rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
97. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me të ardhurën e përfitur nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme në Korçë, të përfitur me anë të privatizimit: *Lidhur me këtë pasaktësi në deklarimin për vitin 2003, iu kalua barra e provës dhe ai shpjegoi se: "[...] shitja e pasurisë në qytetin e Korçës është bërë në vitin 2001, ndërkohë që deklarimi i vitit 2003, si deklarim për herë të parë kërkonte pasqyrimin e situatës fillestare të pasurive. [...] nga ana tjetër, në periudhën 2001-2003, nuk ishte krijuar ndonjë pasuri me burim të ardhurat nga shitja e asaj pasurie. Pra, në formular nuk kishte një rubrikë që të evidentonte detyrimin tim për deklarimin e një të ardhure të krijuar dy vjet më parë se deklarimi fillestar, ndërkohë që ajo nuk kishte krijuar ndonjë pasuri. Rikujtoj se ai ka qenë deklarimi i parë dhe unë, si të gjithë deklaruesit, kisha paqartësi në plotësimin e tij [...]". Nga ky deklarim, subjekti pranon se me të ardhurat nga shitja e pasurisë në Korçë, ai nuk kishte krijuar ndonjë pasuri të re (sikurse është evidentuar edhe gjatë hetimit administrativ). Pra, në vitin 2003, ai ka pasur një likuiditet në shumën prej 1.250.000 lekësh, të cilat nuk i ka deklaruar në deklarimin periodik për vitin 2003, sipas parashikimit të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, por i ka deklaruar si e ardhur ligjore vetëm në deklaratën "vetting", sipas detyrimit ligjor të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Veç sa më sipër, siç u argumentua më sipër në këtë vendim, përfitimi i pasurisë në Korçë, e cila ka krijuar të ardhurën prej 1.250.000 lekësh, ka qenë i paligjshëm, si rrjedhim të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, konsiderohen nga Komisioni si të ardhura të paligjshme.*
- Komisioni, në përfundim të këtij arsytimi, ka arritur në konkluzionin se subjekti ka kryer mosdeklarim të shumës prej 1.250.000 lekësh në deklaratën për vitin 2003 dhe deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa "ç" e ligjit nr. 84/2016, për shkak të deklarimit si e ardhur e ligjshme të shumës prej 1.250.000 lekësh.
98. Shkakun e ankimit të ngritur për konkluzion të gabuar lidhur me trajtimin e kësaj të ardhure, subjekti i rivlerësimit e mbështet në pretendimet dhe parashtrimet e tij si më poshtë.
- 98.1. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën për herë të parë likuiditetin në shumën prej 1.250.000 lekësh, i cili sipas Komisionit ka qenë gjendje në vitin 2003, duke qenë se subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë së

paluajtshme në Korçë nuk kishte krijuar asnjë pasuri tjetër, është konkluzion i gabuar, i pabazuar në prova dhe, mbi të gjitha, konkluzion i bazuar në supozime të Komisionit dhe jo rrjedhojë e veprimeve hetimore në drejtim të sa më sipër.

98.2. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet atribuimit të faktit të mosdeklarimit të një pasurie, të pretenduar prej tij si ekzistuese, në formën e likuiditetit në vlerën prej 1.250.000 lekësh në momentin e kryerjes së deklarimit të pasurisë për herë të parë në vitin 2003, vetëm në vendimin e arsyetuar të Komisionit dhe arritjen në konkluzion lidhur me këtë fakt, në kuadër të procesit të rivlerësimit, pa ia nënshtruar atë procedurës së hetimit administrativ dhe pa e bërë atë objekt diskutimi me subjektin e rivlerësimit, ka cenuar procesin e rregullt, si pasojë e cenimit të së drejtës së subjektit për t'u njohur me faktet që sjellin pasoja në procesin e rivlerësimit dhe për t'u dëgjuar e mbrojtur lidhur me to.

98.3. Subjekti pretendoi që konkluzioni i Komisionit se deklarimi i të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë, në vlerën prej 1.250.000 lekësh, në deklaratën e pasurisë *vetting*, konsiston në deklarim të rremë nga ana e subjektit, si pasojë e deklarimit të kësaj shume si e ardhur e ligjshme, është konkluzion i gabuar, i pambështetur në ligj dhe në prova. Ky arsyetim i Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, do të çonte në përfundimin se subjektet e rivlerësimit nuk duhet të deklarojnë pasurinë kur gjykojnë se është e paligjshme ose në deklaratë duhet të bëjnë veçimin e pasurive që gjykojnë të ligjshme nga pasuritë që i gjykojnë të paligjshme.

99. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me trajtimin nga Komisioni të së ardhurës së krijuar nga privatizimi i banesës në Korçë, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit lidhur me veprimet hetimore të kryera nga Komisioni, si dhe të konstatimit të fakteve lidhur me krijimin dhe shitjen në vitin 2001 të kësaj pasurie të paluajtshme, trupi gjykues fillimisht vëren se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës vetëm sa i takon gjetjes mbi mosdeklarimin e së ardhurës prej 1.250.000 lekësh, në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, por jo sa i takon kualifikimit ligjor të deklarimit të kësaj të ardhure në deklaratën *vetting*, si deklarim i rremë.

100. Në kontekst të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit në vendim "për deklarim të rremë" të së ardhurës prej 1.250.000 lekë në deklaratën *vetting*, është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, është një pretendim i drejtë dhe i bazuar, për sa kohë u provua se Komisioni nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit asnjë barrë prove lidhur me kualifikimin ligjor që i ka bërë deklarimit të kësaj të ardhure në deklaratën *vetting*, duke i mohuar subjektit në këtë mënyrë të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive lidhur me çështje të cilat sjellin pasoja ligjore të drejtpërdrejta në statusin e tij ligjor.

101. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e bazueshmërisë së konkluzionit të Komisionit se subjekti, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, nuk ka deklaruar të ardhurën në vlerën prej 1.250.000 lekësh, të krijuar nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë, në vitin 2001, trupi gjykues vlerësoi si vijon.

102. Referuar parashikimeve të nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjektet deklaruese, sipas dispozitave të të njëjtit ligj, detyroheshin të deklarorin të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre, ku në pasuritë e akumuluar përfshiheshin dhe likuiditetet në gjendje *cash* në momentin që subjekteve u lindte detyrimi për deklarim. Ndërkohë, në deklaratën për herë të parë të plotësuar në kuadër të parashikimeve të nenit të sipërcituar, të

dorëzuar në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit më datë 25.03.2004, nuk rezultoi të jetë deklaruar ndonjë pasuri e subjektit të rivlerësimit me burim vlerën e të ardhurës së krijuar nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë në vitin 2001 apo pjesë të saj, përfshirë këtu edhe pasurinë në formën e likuiditetit në gjendje *cash*.

103. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike në vijim, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar këtë të ardhur si burim të ndonjë pasurie të krijuar pas vitit 2003. Gjithashtu, nga hetimi administrativ i kryer në kuadër të kontrollit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, nuk është administruar asnjë e dhënë apo informacion, sipas të cilit mund të ngrihet një dyshim i arsyeshëm në drejtim të mosdeklarimit nga subjekti i rivlerësimit të një pasurie në formën e likuiditetit në gjendje *cash*, në momentin e deklarimit të kryer në zbatim të parashikimeve të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
104. Për rrjedhojë, përfundimi i arritur nga Komisioni për mosdeklarim në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi në vitin 2003, të shumës prej 1 250 000 lekësh, në deklarimin e kryer për herë të parë nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar në fakte dhe në ligj, për sa kohë nga hetimi i kryer për kriterin e pasurisë nuk rezultoi asnjë e dhënë që mund të ngrinte një dyshim për ekzistencën e një likuiditeti, gjendje *cash*, në vlerën prej 1 250 000 lekësh, në momentin e kryerjes së deklarimit nga ana e subjektit, sikundër dhe ligji nuk parashikonte asnjë detyrim për deklarimin e të ardhurave të krijuara deri në momentin e deklarimit, nga burime të ndryshme, përfshirë dhe shitjen e pasurive të subjekteve. Subjekti me të drejtë ka pretenduar në ankim se ai nuk mund të deklaronte në formën e likuiditetit gjendje “cash” në kushtet kur ajo nuk ekzistonte.
105. Gjithashtu, sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit lidhur me kundërshtimin si të pabazuar në ligj të konkluzionit të arritur nga Komisioni për deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting* të së ardhurës në vlerën prej 1 250 000 lekësh, të krijuar nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë në vitin 2001, me arsyetimin se kjo e ardhur është e ardhur e paligjshme, trupi gjykues vlerësoi se, referuar parashikimeve të nenit 30 dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të përmbushjes së objektit të kontrollit lidhur me kriterin e pasurisë, subjektet e rivlerësimit detyrohen të deklarojnë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, çdo të ardhur të krijuar nga çdo veprimtari apo angazhim, pavarësisht vlerësimit nëse kjo e ardhur përmbush standardet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 19 dhe 30 të ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme, vlerësim ky i cili është atribut vetëm i organeve të kontrollit. Në këtë kuptim, deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë të ardhur, e cila provohet si e tillë në vlerën dhe burimin e saj, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2001, përpara noteres F. B., vlerësohet si deklarim i saktë, në përputhje me ligjin. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky shkak ankimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se Komisioni ka gabuar në vlerësimin e kësaj të ardhure të krijuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2001.
106. Në kushtet kur trupi gjykues e gjeti konkluzionin e Komisionit për deklarim të rreme të kësaj të ardhure në deklaratën e pasurisë *vetting* të pabazuar, e çmoi të panevojshme korrigjimin e shkeljes së konstatuar për cenim të procesit të rregullt në lidhje me të drejtën e subjektit për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, në kuptim të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
107. Lidhur me shkakun e ankimit mbi konkluzionin e arritur nga Komisioni për çështjen e përfitimit nga subjekti i rivlerësimit të kredisë me kushte lehtësuese në shumën e 5 000 000 lekëve, në vitin

2000, të cilin subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi si konkluzion të gabuar, të pambështetur në ligj dhe në prova dhe rrjedhojë të një procesi vendimmarrjeje në cenim të parimit të objektivitetit dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

108. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në arsyetimin e tij në vendim lidhur me çështjen e përfitimit të statusit të të pastrehut nga subjekti i rivlerësimit dhe lidhur me trajtimin e çështjes së privatizimit të banesës në Korçë, vihet re se ka arsyetuar lidhur me çështjen objekt ankimi, si më poshtë.

*Gjatë hetimit administrativ, u vërtetua se subjekti ka përfituar më shumë se një herë kredi me statusin si i pastrehë, sipas VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, status i konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 05.01.2000, të Këshillit të Ministrave.*

*Konkretisht, me kontratën e huas me nr. {***}, datë 24.03.2000, me palë, huadhënës Banka e Kursimeve dhe palë huamarrës, z. Arqilea Koça, ky i fundit ka përfituar një kredi në shumën prej 5.000.000 lekësh, me statusin e të pastrehut, për blerjen e pasurisë apartament banimi, me sip. 100 m² ndodhur në rr. "{***}", pall. {***}, ap. {***}, Tiranë. [...] Lidhur me marrjen e kredisë lehtësuese, u konstatua se:*

- Në kohën e marrjes së kredisë, datë 20.03.2000, edhe pse subjekti nuk ka qenë pronar de jure mbi sip. 830 m² (të cilën e bleu juridikisht tre muaj pas përfitimit të kredisë), ai ka qenë posedues real i kësaj pasurie që nga viti 1996.

*- Subjekti ka banuar që nga viti 1996 - 2000, në objektin me sip. 36 m² në {***}, Tiranë, pra ka pasur një banesë (ndonëse provizore, siç subjekti pretendoi dhe vërtetoi). Sipas parashikimit të pikës 6 të VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, ai duhet të përfitonte kredi në shumën 2.500.000 lekë, si funksionar që ka pasur nevojë për sipërfaqe shtesë banimi, dhe jo kredi në shumën prej 5.000.000 lekësh.*

Nisur nga ky fakt, por edhe nga vlerësimi tërësor i rrethanave, Komisioni çmon se subjekti ka përfituar kredinë lehtësuese me statusin e të pastrehut, në tejkalim të kriterëve të parashikuara në VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999.

109. Në përfundim, në pjesën e fundit të vendimit, Komisioni në “Vlerësimin tërësor të çështjes”, teksa rendit faktet dhe rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi i tij lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, cilëson si një ndër to: *Përfitimi i kredisë me statusin e të pastrehut në shumën prej 5.000.000 lekësh, më shumë se një herë, në kundërshtim me ligjin dhe në tejkalim të kriterëve të përcaktuara në VKM- në nr. 102, datë 05.03.1999.*

110. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit të ngritur në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, e mbështet në sa më poshtë.

110.1. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese më shumë se një herë dhe në kundërshtim me ligjin, është konkluzion i gabuar, i pambështetur në ligj dhe në prova.

110.2. Vendimmarrja e Komisionit lidhur me vlerësimin e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese është arritur duke u bazuar në konstatime të pavërteta ose dhe më rënduese nga sa përshkruhet në pjesën arsyetuese të vendimit, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e objektivitetit në vendimmarrje. Gjithashtu, konstatimi se kredia është përfituar “më shumë se një herë” apo “në kundërshtim me ligjin” nuk ka rezultuar gjatë hetimit apo seancës dëgjimore dhe nuk i është bërë prezent subjektit të rivlerësimit përpara vendimit përfundimtar të Komisionit, duke cenuar të drejtën e subjektit për t’u dëgjuar lidhur me këto konstatime.

111. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me çështjen e përfitimit nga subjekti i rivlerësimit të kredisë me kushte lehtësuese në vitin 2000, në masën e 5.000.000 lekëve, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konstatoi se në kuadër të përmbushjes së detyrimit të parashikuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting* edhe dokumentacionin justifikues lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së paluajtshme apartament banimi në rrugën “{***}”, për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese. Referuar këtij dokumentacioni, rezultoi se me shkresën nr. {***} prot., datë 05.01.2000, të Këshillit të Ministrave, është përcjellë lista e personave që do të trajtohen me kredi, listë e cila është miratuar nga Kryeministri dhe në përbërjen e saj, në numrin rendor {***}, paraqitet emri i subjektit të rivlerësimit, si funksionar i Prokurorisë së Përgjithshme, përfitues me status “i pastrehë” dhe nevojë për kredi në vlerën 5.000.000 lekë. Kjo listë i është përcjellë edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Kursimeve.
112. Në kuadër të korrespondencës për qartësimin e çështjes së përfitimit të kësaj kredie, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision gjatë hetimit edhe shkresën nr. {***} prot., datë 20.07.1999, të Prokurorit të Përgjithshëm, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, me anë të së cilës kërkohet: *Në mbështetje të vendimit nr. 102, dt. 05.03.1999, pika 1, germa “c”, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” dhe në vijim të shkresës sonë me nr. {***}, datë 23.03.1999, kërkojmë trajtimin me strehim nëpërmjet sistemit të kredive për prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme Arqilea Koça, prokuror i seksionit të luftës kundër krimit të organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme. [...].*
113. Në datën 24.03.2000, referuar dokumentacionit të fashikullit të çështjes, subjekti i rivlerësimit dhe Banka e Kursimeve kanë lidhur kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., me vlerë 5.000.000 lekë, me afat 25 vjet dhe me interes bankar 3%, me objekt blerje banese.
114. Në analizë të parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm të kohës, trupi gjykues konstatoi se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” (në vijim “vendimi i KM-së nr. 102, datë 05.03.1999”), i cili në pikën 1, germa “c” përfshinte në gamën e subjekteve përfituese edhe subjektin e rivlerësimit, ka dalë në bazë të parashikimeve të nenit 12, të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 28.12.1998, “Për dhënien e fondeve buxhetore për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.
115. Neni 12 i ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, i cili ka shërbyer si bazë ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor të Këshillit të Ministrave si më sipërcituar, parashikonte shprehimisht: *Funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë gëzojnë këto të drejta: [...] Të drejtën për t’u strehuar në kushte të përshtatshme pranë vendit të punës, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.*
116. Ndërkohë, referuar pikës 2 të vendimit të KM-së nr. 102, datë 05.03.1999, parashikohej shprehimisht që subjekteve përfituese sipas pikës 1 të të njëjtit vendim, u lindte e drejta të kërkonin strehim nga shteti, gjatë kohës që janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi. Në kuadër të përcaktimit të modaliteteve lidhur me zbatimin e këtij vendimi, në pikën 5 të tij përcaktohej: *Listat për marrjen e kredive nga funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhen me miratimin e Kryeministrit, pas kërkesës së motivuar të ministrive dhe*

institucioneve përkatëse. Listat për marrjen e kredive, sipas paragrafit të mësipërm, dërgohen në Bankën e Kursimeve nga Kryeministri. Banka respekton emrat dhe radhën e vendosur në këto lista nga Kryeministri. Referuar pikës 6 të të njëjtit vendim, kredia jepej me vlerë deri në 5 milionë lekë, me interes 3% dhe afat kthimi deri në 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të cilët nuk kanë banesë dhe deri në 2,5 milionë lekë me interes 3% e afat kthimi deri në 15 vjet për ata që duan shtesë sipërfaqeje banimi.

117. Trupi gjykues, në vlerësim të përmbushjes nga ana e subjektit të kriterit të mospasjes së një banese në kushte të përshtatshme pranë vendit të punës, në respektim të parashikimeve ligjore dhe nënligjore si më sipër cituar, pasi verifikoi aktet e administruara nga ZVRPP Tiranë, për gjendjen e pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimit deri në datën e lidhjes së kontratës së huas me Bankën e Kursimeve, konstatoi se ai nuk rezultonte të kishte në pronësi të tij ndonjë banesë në qytetin e Tiranës. Sa i takon arsyetimit të Komisionit në lidhje me objektin me sip. 36 m², të ndërtuar në {***} për qëllime strehimi, trupi gjykues, në vijim të analizës në paragrafët pararendës në këtë vendim, çmoi se, pavarësisht faktit se subjekti ka jetuar realisht në atë objekt, si pasojë e nevojës së momentit për strehim, ai objekt për nga natyra e ndërtimit nuk përmbushte asnjë prej kërkesave themelore për t'u vlerësuar ndërtesë me destinacion ekonomik banimin dhe, për rrjedhojë, nuk ndikon në këtë kuptim analizën e mësipërme në drejtim të përmbushjes së kriterëve për të përfitur nga parashikimet e vendimit të KM-së nr. 102, datë 05.03.1999.
118. Në vlerësimin tërësor të sa më sipër parashtruar, trupi gjykues arriti në konkluzionin se përfitimi nga subjekti i rivlerësimit i kredisë me kushte lehtësuese është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore të kohës në të cilën është miratuar dhënia e saj, qoftë në drejtim të plotësimit të kriterëve për përfitimin e saj, qoftë sa i takon procedurës së ndjekur për dhënien/miratimin e saj. Subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë përfitur vetëm një herë kredi me kushte lehtësuese me vlerë 5000000 lekë, dhe kjo në kuadër të së drejtës së tij për t'u mbështetur nga shteti me strehim të përshtatshëm në vendin ku ushtronte funksionin e tij të prokurorit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit se subjekti ka përfitur kredi me kushte lehtësuese më shumë se një herë, është i gabuar, sikundër dhe konkluzioni se kjo kredi është përfitur në kundërshtim me ligjin dhe në tejkalim të kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999, nuk rezultoi i bazuar në fakte.
119. Në kuadër të analizës së mësipërme, gjendet i drejtë dhe i bazuar edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i arritur nga Komisioni është bazuar në konstatime të pavërteta dhe, për rrjedhojë, ky konkluzion është arritur në mosrespektim të parimit të objektivitetit në gjykim. Gjithashtu, nga analiza e gjetjeve të hetimit administrativ, sipas dokumentit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues konstatoi se subjektit nuk i është bërë me dije fakti i pretenduar nga Komisioni se kredia është përfitur më shumë se një herë, duke cenuar në drejtim të sa më sipër të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor. Edhe pse në një rast të tillë, bazuar në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji duhet të vlerësonte gjykimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të drejtën për t'u dëgjuar e mbrojtur, në vijim të analizës së mësipërme, sipas së cilës konkluzioni i Komisionit nuk është i bazuar në fakte e në ligj, gjykimi në seancë gjyqësore publike për efekt të korigjimit të gabimit procedural, u vlerësua i panevojshëm. Në përfundim, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar edhe këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

120. Sa i takon shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, për kundërshtimin si të padrejta dhe të pabazuara të konkluzioneve të Komisionit për përfitimin e pasurisë së paluajtshme në Korçë sipas kontratës së privatizimit, datë 05.07.2000, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore" dhe ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" dhe "duke përdorur funksionin e tij si prokuror", si dhe të aludimeve të Komisionit për sjellje joetike në pranimin e privatizimit të kësaj pasurie në vitin 2000, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

121. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me çështjen e privatizimit nga subjekti i rivlerësimit të banesës në Korçë, ka arsyetuar në vendimin e tij si më poshtë.

Nga të gjitha sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se:

1. Subjekti ka përfituar, me statusin si i pastrehë, në korrik të vitit 2000, një pasuri në Korçë, truall me sip. 100 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², pasi në mars të vitit 2000, ai e kishte konsumuar marrjen e kredisë prej 5.000.000 lekësh për blerjen e një banese në Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 102, datë 05.03.1999, pika 2, "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë". Sipas pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" të cilit i referohet VKM-ja nr. 102, datë 05.03.1999, parashikohet se, me përdorimin e shumës së përfituar, familjes i hiqet statusi si i pastrehë. [...]

2. Në kontratën për privatizimin e banesës, datë 05.07.2000, palë shitëse është ish-NKB, ndërkohë vërtetimin e nënshkrimit të kësaj kontrate, palë shitëse rezulton të jetë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

3. Vetë subjekti deklaroi se pasuria është përfituar për shkak të një të drejte për strehim që ai e ka pasur në periudhën kur ka punuar në Korçë. Ndërkohë, nga vetëdeklarimet e subjektit, nuk rezultoi e vërtetuar që ai të ketë banuar me statusin e ish-qiramarrësit në një banesë të ish-NKB-së, të cilën do të mund që ta privatizonte me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7652/1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore". Gjithashtu, nga deklarimet e tij, por dhe dokumentet e administruara, u vërtetua se kjo pasuri nuk ka qenë pronë e ish-NKB-së, por ka qenë në pronësi të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Është e paqartë se si është përfituar dhe si është regjistruar në emër të subjektit sipërfaqja e objektit prej 100 m², dhe aq më tepër sipërfaqja prej 100 m² truall, ndërkohë që kontrata për privatizim banese, shprehet për një apartament [...]. Me ligjin për privatizimin e banesave ish-pronë e NKB-së 7652/1992 lejohej privatizimi vetëm i apartamenteve të banimit në posedim me qira nga banorët, dhe jo i trojeve të objekteve.

Nga të gjitha sa më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se:

Privatizimi i pasurisë në Korçë, përfituar nga subjekti me statusin si i pastrehë, më datë 05.07.2000, pasi ai kishte marrë kredi në Tiranë, më datë 20.03.2000, po me statusin si i pastrehë, pasuri e shitur brenda vitit të privatizimit, më datë 26.03.2001, është përfituar në kundërshtim me VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999, në mënyrë të padrejtë dhe me qëllim përfitimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke përdorur funksionin e tij si prokuror.

Argumenti se kjo pasuri ishte një e drejtë që i takonte, nuk qëndron, pasi me transferimin në Tiranë (ku dhe për shkak të punës ka marrë kredi si i pastrehë), e drejta për t'u strehuar në qytetin e Korçës kishte përfunduar. [...] privatizimi i një pasurie në Korçë, ku ai nuk ishte duke ushtruar më funksionet e tij, shitja e kësaj pasurie brenda vitit kur fitoi titullin e pronësisë, tregon se qëllimi i privatizimit të kësaj pasurie nuk i shërbeu ushtrimit të detyrave nga ana e tij [...], por fitimit të disa të ardhurave, të cilat i ka përdorur si burim për krijimin e pasurive të fituara më pas [...].

122. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit për kundërshtimin e konkluzionit të arritur nga Komisioni si më sipër parashtruar, e mbështet në shpjegimet dhe pretendimet e mëposhtme.

122.1. Konkluzioni i Komisionit se privatizimi i kësaj pasurie është kryer në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” dhe ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, sipas subjektit të rivlerësimit është i gabuar dhe parashikimet ligjore të cilave u referohet Komisioni në arritjen e këtij konkluzioni, nuk e konsiderojnë këtë situatë të paligjshme privatizimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto parashikime i referohen një situatë të ndryshme faktike.

122.2. Subjekti sqaroi se në vitin 1993, ai ka bërë transferimin e gjendjes civile nga qyteti i {***} në qytetin e Korçës, ku ushtronte detyrën e tij dhe gjatë kësaj periudhe ka fituar statusin “i pastrehë” dhe, si rrjedhojë, ishte në listat e pritjes së Bashkisë Korçë për t’u trajtuar me sipërfaqe banimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, bashkia e qytetit të Korçës, për shkak të mungesës së apartamenteve të banimit, kishte vendosur që për plotësimin e kërkesave të familjeve që ishin në listën e pritjes së qytetarëve si të pastrehë, të përdorte ambiente që më parë ishin të ndërmarrjeve që ushtronin veprimtarinë në qytetin e Korçës, por që për shkak të ndryshimit të sistemit nuk e ushtronin më. Në këtë kontekst, Këshilli Bashkiak i Korçës vendosi që për plotësimin e kërkesës së subjektit, të bërë që në kohën kur ai ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Korçë, t’i jepte për privatizim një ambient të ish-ndërmarrjes artistike, të ndodhur në qytetin e Korçës.

122.3. Komisioni, sipas subjektit, nuk ka individualizuar përgjegjësinë e tij në privatizimin me vonesë të kësaj prone, dhe në mënyrë të padrejtë e ka ngarkuar atë me përgjegjësi për pranimin e këtij privatizimi të iniciuar me kërkesë të tij në një situatë të caktuar faktike rreth 7 vite më parë. Subjekti pretendoi se veprimet e tij në përfitimin e privatizimit të kësaj pasurie të paluajtshme në qytetin e Korçës, nuk kanë asgjë të paligjshme pasi nuk kanë shkelur asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore.

122.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuara aludimet e Komisionit për sjellje joetike në pranimin e privatizimit të kësaj pasurie në vitin 2000, në mungesë të përcaktimit të shkeljes konkrete të Kodit të Etikës apo edhe të ndonjë standardi të mirëvendosur që të elaborojë sjelljen joetike të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret.

122.5. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit, se ky përfitim është realizuar “duke përdorur funksionin e tij si prokuror”, është i pavërtetë, i pambështetur në asnjë provë të procesit dhe konkluzion që për më tepër bie ndesh me historikun 10-vjeçar të problemeve të tij me strehimin.

123. Në shqyrtim të shkakut të ankimit lidhur me çështjen e privatizimit nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme “banesë” në Korçë, në kuadër të përfitimeve sipas statusit të “të pastrehut”, si dhe me qëllim kontrollin e vendimmarrjes së Komisionit lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të krijuar gjatë hetimit në Komision, si dhe i legjislacionit të zbatueshëm në kohën në të cilën është kryer privatizimi i kësaj banese, trupi gjykues vëren si më poshtë vijon.

124. Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP Korçë, por dhe nga aktet bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* nga ana e subjektit, në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se më datë 05.07.2000, është lidhur një kontratë për privatizim banese,

sipas formularit nr. {***} nga NK Banesa, përfaqësuar nga z. S. C., Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të Bashkisë Korçë dhe subjektit të rivlerësimit. Objekti i privatizimit përshkruhet në kontratë: *banesë nr. _____, Shëtitorja {***}, pall. ish-artistike [plotësuar me shkrim dore], shk. _____, kati për. [plotësuar me shkrim dore], e përbërë nga 1 dhomë, 1 kuzhinë me aneks.* Ndërkohë, në planimetrinë që shoqëron kontratën, objekti përshkruhet: *Banesë 1 Dh + Dhd, Aneks, banjo, "1 kat".* Sa më sipër, konstatohet se banesa në fjalë është një banesë 1-katëshe dhe jo një apartament i një pallati.

125. Në kontratën e privatizimit të banesës është vendosur si bazë ligjore për përcaktimin e çmimit të kësaj banese, *ligji nr. 8122, datë 09.07.1999.* Nga verifikimi i kryer në Kolegj, rezultoi se sipas ligjit të sipërcituar, Kuvendi Popullor në atë kohë ka miratuar pa ndryshime dekretin nr. 1440, datë 04.04.1996, "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara", në nenin 1 të të cilit përcaktohej: *Banesat shtetërore që nuk janë privatizuar deri në datën 31 dhjetor 1995, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe që nuk janë subjekt i ligjit nr. 7658, datë 15.04.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" kalojnë në administrim të organeve të pushtetit lokal në bashki e komuna, sipas vendndodhjes së banesës.* Në vijim, neni 2 i këtij dekreti parashikonte shprehimisht se këshillat e bashkive ose të komunave, në varësi nga vendndodhja e banesave do të vendosnin për privatizimin e tyre, sipas kriterëve të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ndryshe nga sa është shprehur Komisioni në vendim, nuk ka asnjë paqartësi se përse kontrata e privatizimit në këtë rast është nënshkruar nga përfaqësuesit e strukturave lokale që kishin marrë tashmë në administrim këto banesa shtetërore, dhe jo nga përfaqësuesit e ish-NKB-së.
126. Duke qenë se privatizimi i banesës në Korçë është kryer sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", i cili në nenin 10 të tij përcakton: *Trualli që zë ndërtesa e banimit vlerësohet si zë i veçantë dhe kalon në bashkëpronësi të pronarëve të banesës,* në rastin në fjalë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se paqartësitë e deklaruara në vendim nga Komisioni – [...] *Është e paqartë se si është përfutur dhe si është regjistruar në emër të subjektit sipërfaqja e objektit prej 100 m², dhe aq më tepër sipërfaqja prej 100 m² truall, ndërkohë që kontrata për privatizim banese shprehet për një apartament një dhomë, një kuzhinë me aneks [...]. Me ligjin për privatizimin e banesave ish-pronë e NKB-së 7652/1992 lejohej privatizimi vetëm i apartamenteve të banimit në posedim me qira nga banorët, dhe jo i trojeve të objekteve – janë konstatime të fakteve të cilat në mënyrë të pajustificuar nuk i janë nënshtruar hetimit të thelluar nga Komisioni në drejtim të analizës së kuadrit ligjor të kohës për t'u cilësuar apo jo si "gjetje" në kuadër të këtij procesi. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstatoi se privatizimi i banesës dhe regjistrimi i saj në ZVRPP Korçë, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni në vendim, është bërë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe nuk paraqet asnjë paqartësi në drejtim të sa më sipër.*
127. Subjekti i rivlerësimit gjatë kohës që ka jetuar në qytetin e Korçës, si pasojë e faktit që ka ushtruar detyrën e tij në Prokurorinë e Rrethit Korçë dhe në Prokurorinë e Rrethit Devoll, në periudhën nga viti 1989 – 1994, rezultoi në këtë përfutur statusin e të pastrehut, në kategorinë e "qytetarëve qiramarrës në banesë private"²⁶. Referuar parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993, "Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët", i dalë në

²⁶ Ky fakt referohet si një informacion sqarues edhe në shkresën nr. {***} prot., datë 20.07.1999, të Prokurorit të Përgjithshëm të kohës në kuadër të korrespondencës së tij me organet e tjera shtetërore, në kuadër të trajtimit të nevojave të subjektit të rivlerësimit për strehim.

zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, konstatohet se qytetarët që kanë banuar si qiramarrës në banesa private, konsideroheshin të pastrehë referuar parashikimeve të pikës 1, shkronja “ç” e vendimit të sipërcituar. Në pikën 2 të po këtij vendimi përcaktohej: *Ngarkohen komisionet e privatizimit pranë këshillave të rretheve, bashkive e komunave të përcaktojnë këtë kategori qytetarësh dhe listën përkatëse të firmosur nga kryetari i rrethit ose i bashkisë dhe ta depozitojnë pranë degës së Entit Kombëtar të Banesave të rrethit përkatës.* Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 29.01.1993, “Për zbatimin e ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, komisionet e privatizimit pranë këshillave të rretheve ishin strukturat lokale të ngritura sipas këtij akti nënligjor dhe me detyrë organizimin e punës për zbatimin e ligjit për privatizimin e banesave shtetërore. Në vijim të analizës së këtij kuadri ligjor të kohës, konstatohet se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti nuk mund të përfitonte sipas dispozitave të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, pasi nuk rezultonte të kishte qenë “qiramarrës në banesë shtetërore”, është i pambështetur në ligj. Subjekti rezulton të ketë marrë statusin “i pastrehë” pikërisht në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 7652, datë 23.012.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, sipas akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave, të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit të sipërcituar.

128. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se konstatimet e Komisionit lidhur me paqartësitë e tij në disa elemente të privatizimit të banesës shtetërore në qytetin e Korçës, si dhe ato lidhur me faktin se privatizimi i kësaj banese ishte kryer në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, nuk janë të bazuara në ligj, për rrjedhojë dhe konkluzioni i tij, i arritur bazuar në këto konstatime të gabuara, nuk gëzon mbështetje ligjore.
129. Në kuadër të kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit, sipas së cilës: *Subjekti ka përfituar, me statusin si i pastrehë, në korrik të vitit 2000, një pasuri në Korçë, truall me sip. 100 m² dhe ndërtesë me sip. 100 m², pasi në mars të vitit 2000 ai e kishte konsumuar marrjen e kredisë prej 5.000.000 lekësh për blerjen e një banese në Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 102, datë 05.03.1999, pika 2, "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë". Sipas pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" të cilit i referohet VKM-ja nr. 102, datë 05.03.1999, parashikohet se, me përdorimin e shumës së përfituar, familjes i hiqet statusi si e pastrehë [...] – me qëllim vlerësimin nëse marrja e kredisë prej 5.000.000 lekësh, sipas vendimit të KM-së nr. 102, datë 05.03.1999, përbënte kriter përjashtues për privatizimin nga subjekti i rivlerësimit të banesës në Korçë, trupi gjykues çmoi të nevojshme të marrë në analizë raportin që ekzistonte mes parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, dhe parashikimeve të ligjit nr. 8030, datë 05.03.1999, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.*
130. Më konkretisht, sa i takon vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, rezultoi që ky akt nënligjor ka dalë në zbatim të një kuadri ligjor²⁷ i cili synonte garantimin e një statusi të veçantë funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore, ku një ndër të drejtat e garantuara me ligj ishte edhe e drejta për t'u strehuar në kushte të përshtatshme pranë vendit të punës. Në kuadër të këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë kohë, subjekti i rivlerësimit rezultoi që në vijim të kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme të jetë

²⁷ Baza ligjore si më sipër, parashtruar në vendim, është neni 12 i ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”.

përfshirë në listën e funksionarëve që do të përfitonin një kredi me kushte lehtësuese, me qëllim sigurimin e një strehimi të përshtatshëm në Tiranë.

131. Ndërkohë, si më sipër konstatuar në këtë vendim, statusi “i pastrehë”, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993, i kishte lindur subjektit të rivlerësimit në vitin 1993, si pasojë e faktit që në atë periudhë ai rezultonte të jetonte me qira në banesë private dhe për rrjedhojë, në kuadër të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” i lindi e drejta të përfitonte nga zbatimi i ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, përfitim ky i cili u bë efektiv me nënshkrimin e kontratës së privatizimit më datë 05.07.2000.
132. Trupi gjykues konstatoi se në vitin 1995, u miratua ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me qëllim përcaktimin e detyrimeve financiare të shtetit për të pastrehët që rezultonin nga zbatimi i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, si dhe mënyrën e dhënies së kredisë për ta, duke lehtësuar zgjidhjen e strehimit të tyre dhe duke krijuar mundësi për të përfituar nga tregu i lirë i tokës dhe i banesave, ligj ky i cili hynte në fuqi në vitin 1996. Referuar parashikimeve të nenit 2, sipas këtij ligji, çdo familje e pastrehë përfitonte falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash, vlera dhe përdorimi i së cilës përcaktohej sipas parashikimeve të këtij ligji. Referuar nenit 6 të të njëjtit ligj, me përdorimin e kësaj shume familjes i hiqej statusi i të pastrehës.
133. Në analizë të kuadrit të mësipërm ligjor dhe nënligjor, trupi gjykues vlerësoi se kredia e përfituar nga ana e subjektit të rivlerësimit sipas vendimit të KM-së nr. 102, datë 05.03.1999, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të ekuivalentohet, dhe të trajtohet njësoj, me shumën e përfituar sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, për nga pasojat që ajo sjell në përfundimin e statusit të të pastrehut, sipas parashikimeve të nenit 6 të po të njëjtit ligj, për sa kohë përfitimet financiare si më sipër burojnë nga dy akte ligjore të ndryshme, objekti dhe subjektet e të cilëve nuk janë të njëjtë, fokusi në trajtimin e çështjes së strehimit është i ndryshëm dhe mbi të gjitha, në mungesë të një parashikimi të shprehur ligjor.
134. Në vlerësim të trupit gjykues, edhe pse kontributet financiare sipas këtyre dy akteve të ndryshme ligjore si më sipër cituar, kanë të njëjtën natyrë referuar qëllimit për të zgjidhur apo lehtësuar çështjen e strehimit të personave pa banesë, si dhe rrjedhin nga të njëjtat burime financiare (buxheti i shtetit), analiza lidhur me këto parashikime ligjore në asnjë rast nuk duhet të kryhet në drejtim të vlerësimit të etikës së subjektit përfitues, në pranimin e privatizimit të banesës në Korçë, si përfitim i vonuar në kohë i një të drejte të kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se situata të kësaj natyre, të cilat krijohen si pasojë e zbatimit të vonuar në kohë të legjislacionit në fuqi, dhe jo të veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk duhen vlerësuar si çështje që lidhen me etikën e subjektit përfitues dhe, për rrjedhojë, të sjellin pasoja juridike në dëm të këtij të fundit. Për më tepër kur një sjellje e tillë e subjektit të rivlerësimit, përveçse nuk përbën një shkelje ligjore dhe nuk rezulton të jetë parashikuar në kohën kur ajo ka ndodhur as si një shkelje etike apo sjellje që cenon parime dhe standarde të pranuar të etikës, mbi të gjitha konsiston në realizimin e një të drejte që i takonte subjektit të rivlerësimit si qytetar i Republikës së Shqipërisë për të përfituar nga tregu i lirë i tokës dhe i banesave, në kuadër të proceseve të privatizimit të pronës shtetërore.
135. Sa i takon shqyrtimit të pretendimeve të subjektit në lidhje me qëndrimin e Komisionit në vendim, sipas të cilit ky privatizim është realizuar me qëllime përfitimi duke shfrytëzuar funksionin e tij si prokuror, trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë kërkesat e subjektit për strehim,

në të dyja rastet janë kryer në përmbushje të të drejtave të garantuara atij me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore e nënligjore, dhe për sa kohë gjatë hetimit administrativ nuk është administruar asnjë e dhënë për veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat ngrenë dyshime për përfshirje të tij të paligjshme në trajtimin prej strukturave përkatëse shtetërore të këtyre kërkesave, ky konkluzion i Komisionit nuk gjendet i bazuar. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar edhe këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

136. Në përfundim të vlerësimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin e vlerësimit të Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se në rastin në gjykim, konkluzionet e kundërshtuara të Komisionit, sipas ankimit objekt gjykimi, të cilat janë dhe konkluzionet mbi bazën e të cilave Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se në vlerësimin tërësor të rrethanave, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke i dhënë atij masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, u gjetën të pabazuara në faktet e konstatuara dhe në ligj. Për rrjedhojë, nga vlerësimi dhe kontrolli i imtësishëm i kryer në Kolegj lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit objekt ankimi, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij, si dhe nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit lidhur me këtë kriter vlerësimi është i cenueshëm dhe duhet të ndryshohet.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me shkeljen e parimeve të përgjithshme në kuadër të procesit të rregullt ligjor dhe çështje të zbatimit të ligjit

137. Sa u takon shkaqeve të ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të kryer në Komision, si dhe për çështje të zbatimit të ligjit nga ana e Komisionit, trupi gjykues thekson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim janë trajtuar në mënyrë të hollësishme më sipër, në kuadër të analizës së shkaqeve të ngritura në ankim lidhur me kriterin e pasurisë dhe, për rrjedhojë, shihet i panevojshëm arsyetimi në kuadër të trajtimit si shkaqe të pavarura të ankimit të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, bazuar në konkluzionin e arritur lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmoi të panevojshëm arsyetimin lidhur me shkaqe të natyrës procedurale dhe të zbatimit të ligjit material në tërësi, në kuadër të vlerësimit nëse vendimmarrja e Komisionit është e cenueshme në këtë kuptim.
138. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme dhe në konkluzionet e arritura në vendimin e Komisionit për mungesën e problematikave në elementet e tjera të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe në konkluzionet për dy kriteret e tjera të rivlerësimit kalimtar të tij, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka arritur:
- a) nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
 - b) nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
 - c) nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale; si dhe
 - ç) nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça të konfirmohet në detyrën e tij.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenet 59, pika 1 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 113, datë 08.03.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça dhe konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.12.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret në pakicë, Natasha Mulaj dhe Rezarta Schuetz, votuam kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Arqilea Koça. Në vlerësimin tonë, në analizë të fakteve dhe provave të administruara në dosje dhe pretendimeve të paraqitura në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë arsye, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që vendosi shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.
2. Në vlerësimin tonë, në zgjidhjen e çështjes, trupi gjykues i Kolegjit duhet ta fokusonte analizën duke iu përgjigjur së pari pyetjes nëse konkluzionet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në vendimin nr. 113, datë 08.03.2019, përkundër shkaqeve të ankimit qëndronin, tërësisht apo pjesërisht, dhe së dyti, nëse në përfundim të analizës së kryer, në vlerësimin tërësor, rezultonte se subjekti kishte arritur nivel të besueshëm dhe duhej të konfirmohej në detyrë. Arsyetimi ynë më poshtë, për lehtësi leximi, është strukturuar të ndjekë konkluzionet përfundimtare të vendimit të Komisionit²⁸ për rrethanat që, duke qenë pjesë e vlerësimit tërësor, kanë përbërë bazë për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

2.1. Rezulton se më datë 05.07.2000, subjekti i rivlerësimit ka privatizuar një pasuri të paluajtshme me statusin *e të pastrehut* në qytetin e Korçës. Subjekti i rivlerësimit, në këtë datë, kishte 6 (gjashtë) vite që punonte dhe jetonte në Tiranë, si pasojë e emërimit në Prokurorinë e Përgjithshme më 10.07.1994²⁹ dhe tanimë kishte humbur lidhjet me Korçën apo nevojën për strehim në atë zonë. Po aq e rëndësishme është që katër (4) muaj më herët, subjekti i rivlerësimit kishte përfitur edhe një kredi, si i pastrehë në qytetin e Tiranës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (në vijim “VKM”) nr. 102, datë 05.03.1999, për shkak dhe në funksion të të qenit funksionar publik në Prokurorinë e Përgjithshme. Pasuria në qytetin e Korçës, vlerësuar me 72.000 lekë sipas kontratës së datës 05.07.2000, e përbërë nga truall dhe ndërtesë me sip. 100 m² secila, pronë e ish-Ndërmarrjes Shtetërore Artistike në Korçë, është shitur nga subjekti i rivlerësimit pak muaj më pas, më 26.03.2001, në vlerën prej 1.250.000 lekësh.

2.2. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë transaksion apo të ardhurat e përfituara prej tij ndër vite, duke filluar nga deklarata e parë [e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie], datë 25.03.2004, në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003³⁰. Subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë kur është pakësuar *cash*-i i përfitur nga shitja. Për herë të parë, kjo e ardhur është referuar në deklaratën e pasurisë [deklarata *vetting*]. Gjatë hetimit në Komision, pasi iu kalua barra e provës për këtë mangësi, subjekti pretendoi se ishte deklarim i parë, nuk përmbante

²⁸ Faqja 40 e vendimit të Komisionit nr. 113, datë 08.03.2019: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/04/Vendim-Arqilea-Ko%C3%A7a.pdf>.

²⁹ Sipas Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2003.

³⁰ “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, datë 10.04.2003.

rubrikë për krijimin e një të ardhure të krijuar më parë dhe se nga kjo e ardhur nuk ishte krijuar ndonjë pasuri.

2.3. Së pari, vërejmë se këto pretendime të subjektit bien ndesh me faktin që përpos deklaratës së parë, plotësuar në mars 2004, subjekti nuk i ka deklaruar asnjëherë këto të ardhura apo shtesat e pakësimet e tyre, të pretenduara në gjendje jashtë sistemit bankar. Së dyti, mungesa e njohjes së ligjit është e papranueshme për një prokuror karriere, i cili ushtron detyra me përgjegjësi në interpretimin e ligjit.

2.4. Privatizimi i pasurisë në Korçë vlerësojmë të jetë kryer në shkelje të ligjit. Siç është thënë edhe më sipër [paragrafi 2.1.], subjekti i rivlerësimit Arçilea Koça pushoi së qeni i pastrehë në vendin ku punonte, edhe zyrtarisht³¹ minimalisht në mars 2000 – kohë që përkon me marrjen e kredisë në kushte lehtësuese, sipas VKM-së nr. 102/1999, dhe me blerjen e apartamentit. Së dyti, ligji nr. 8122/1996 [dhe dekreti nr. 1440/1996], mbi bazën e të cilit është kryer privatizimi – siç edhe referon kontrata e shitjes mes Ndërmarrjes Komunale Banesa Korçë, përfaqësuar nga z. S. Ç., dhe subjektit të rivlerësimit – ka për qëllim “privatizimin e banesave shtetërore të cilat nuk janë privatizuar deri në datën 31 dhjetor 1995 sipas ligjit nr. 7652/1992”. Nga formulimi i dispozitave përkatëse të ligjit origjinal, del qartë që ky i fundit ka për qëllim t’u japë “[...] të drejtën *qiramarrësve* të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre [...]” sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 7652/1992. Pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar kuadri ligjor, qëllimi ka mbetur nga njëra anë, të pronësojë qytetarët që efektivisht qëndronin *me qira* në pronat shtetërore përkundër tarifave të bazuara në cilësi të vetë banesës apo të qiramarrësit/blerës,³² si dhe t’u lejojë mundësinë qytetarëve *të pastrehë të përfitojnë kredi strehimi në kushte lehtësuese*. Më tej, ligji specifikon se këto përfitime nuk i gëzojnë qytetarët që janë pronarë banesash shtetërore ose ata që kanë ndërtuar apo po ndërtojnë banesa private nga viti 1990 e në vazhdim³³.

2.5. Përpos faktit të kredisë në kushte lehtësuese të përfituar më herët, shtjelluar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka qenë qartësisht edhe në kushtet përjashtuese të parashikuara nga neni 23 i ligjit nr. 7652/1992, për disa arsye. Së pari, sepse subjekti nuk ishte qiramarrës në këtë pronë publike, nuk ishte as i pastrehë dhe as banonte në Korçë prej tetë (8) vjetësh. Së dyti, subjekti kishte përfituar nga privatizimi i banesës në vitin 1993 me prindërit dhe ishte bashkëpronar në ¼ pjesë mbi apartamentin e banimit në Delvinë, në momentin kur përfitoi pasurinë nga privatizimi në Korçë sa më sipër. Së treti, subjekti i rivlerësimit kishte ndërtuar tanimë – pa leje – një objekt në Linzë ku edhe banonte që nga viti 1996, mbi një sipërfaqe toke bujqësore prej 830 m², të cilën e kishte blerë dy muaj përpara privatizimit në Korçë [në detaj edhe në vijim].

2.6. Për të gjitha këto rrethana, ne vlerësojmë se privatizimi i kësaj pasurie shtetërore nga subjekti, në momentin dhe në rrethanat kur ky fakt ndodhi, dëshmon përfitim për shkak të funksionit. Si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe duhet të ishte pranuar.

³¹ Shih edhe pjesën e arsyetimit që lidhet me tokën dhe objektin që ai posedonte që në vitin 1996 në Linzë.

³² Shih nenin 4 të ligjit nr. 7652/1996, sipas të cilit kriteret për përcaktimin e çmimit bazohen në madhësinë e banesës, vlerën në kohën e ndërtimit, vjetërsinë e banesës, vendndodhjen dhe përbërjen familjare të saj.

³³ Neni 23 i ligjit nr. 7652/1992.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se privatizimi në fjalë [i një pasurie jobanesë, edhe sipas tij] përbënte një të drejtë të tij dhe që shteti “ta ofronte në realizimin sa më të mirë të funksionit” janë kontradiktore në vetvete në disa nivele. Për shkak të kredisë së përfituar më herët atë vit dhe transferimit në Tiranë prej vitesh, subjekti nuk ishte i pastrehë në asnjë qytet. Së fundmi, fakti që pasuria nuk ishte banesë dhe as u përdor prej tij si e tillë, përjashton edhe konceptualisht arsyen për të cilën ai pretendon se e fitoi këtë të drejtë – strehimin. Kjo ilustron qartë edhe nga fakti që subjekti e shiti pronën brenda pak muajsh [mars 2001], në një vlerë 17 herë më të lartë sesa kostoja e blerjes. Të gjitha këto rrethana përjashtojnë qëllimin humanitar – strehimin – dhe dëshmojnë në fakt që transaksioni kishte për qëllim një përfitim financiar për një të drejtë e cila ndërkohë i ishte shuar/pushuar së qeni e perealizuar me kontribut nga shteti për shkak të (i) transferimit nga Korça që në vitin 1994; (ii) blerjes së apartamentit në Tiranë në mars të vitit 2000; (iii) lëvritimit të kredisë në kushte lehtësuese në mars të vitit 2000; dhe (iv) blerjes së tokës arë në maj të vitit 2000, mbi të cilën ndodhej objekti i ndërtuar prej tij në vitin 1996, në Linzë, Tiranë.

2.7. Për të njëjtat arsye, konkluzioni i shumicës në paragrafët 134 dhe 135 se ky transaksion është një “përfitim i vonuar në kohë, i një të drejtë të kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti”, “sipas procedurave përkatëse ligjore e nënligjore”, në vlerësimin tonë përbën një anashkalim të panoramës së plotë dhe një qasje formaliste që injoron faktet e pakontestueshme që lidhen me rrethanat e subjektit në vitin 2000, por edhe arsyet ligjore për të cilat është kryer privatizimi i pasurive ish-shtetërore në Shqipëri në vitet ‘90, apo radhën në të cilën u janë ofruar grupeve të caktuara demografike privatizimet. Të gjitha këto fakte, pavarësisht se dëshmojnë parregullsi të kryera nga organet e pushtetit vendor, nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e subjektit për veprimet e ndërmarra. Shpjegimet e subjektit në procesin e rivlerësimit, në dritë të fakteve të pakontestueshme më sipër, dëshmojnë një qasje të papranueshme për një prokuror që ka shërbyer në nivelet më të larta të drejtësisë shqiptare për 25 vjet.

2.8. Në këtë këndvështrim, vlerësojmë se shumica duhej të përqendrohej vetëm te faktet dhe aktet, e në prani të pasaktësive në shprehje të pasqyruara në vendimin e Komisionit – sipas të cilit subjekti ka përfituar “më shumë se një herë kredi me statusin si i pastrehë” – apo në referimin e gabuar në ligjin nr. 8030/1995³⁴ në mënyrë tangenciale e vetëm për të konstatuar humbjen e statusit të të pastrehut, duhet të kishte cilësuar veprimet e subjektit dhe konkluzionet e Komisionit pa u lidhur nga gabimet e kryera nga ky i fundit në fokusimin në elemente dytësore apo formulime të pasakta. Një qëndrim i tillë do të ishte, ndër të tjera, edhe në funksion të rolit orientues të Kolegjit për Komisionin në zbatim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Kjo analizë, parë së bashku me mungesën e sinqeritetit të subjektit në deklaratimet e para të pasurisë dhe në procesin e rivlerësimit, do duhet të ishte interpretuar nga shumica si situatë e cila minimalisht cenon besimin e publikut.

³⁴ Ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, të cilit i referohet VKM-ja nr. 102, datë 05.03.1999, parashikon që “[...] shumën e përfituar familjet e pastreha mund ta përdorin për blerje banesë nga shteti apo privati, për blerjen e truallit për ndërtim banese nga shteti ose privatët, për pagesën e qirasë së banesës. Me përdorimin e shumës së përfituar, familjes i hiqet statusi i së pastrehës [...]”.

2.9. Përpos sa më lart, sa u përket konkluzioneve të Komisionit që lidhen me kredinë në kushte lehtësuese, është fakt i pakontestueshëm se në momentin kur e përfitoi atë, subjekti i rivlerësimit gëzonte të drejta reale [të posedimit] mbi tokën arë me sipërfaqe 830 m² dhe objektin e ndërtuar *pa leje* që prej vitit 1996, të drejtat e pronësisë mbi të cilën *i zyrtarizoi* vetëm pak javë pasi mori kredinë me kushte lehtësuese. Së dyti, subjekti i rivlerësimit gëzonte zyrtarisht pronësinë e ¼ së apartamentit të privatizuar në vitin 1993 në Delvinë, jo vetëm gjatë kohës kur përftoi kredinë me kushte lehtësuese apo privatizoi një pjesë të ndërmarrjes ish-pronë publike si i pastrehë, por edhe përgjatë procesit të rivlerësimit. Pretendimet e tij, një prokuror karriere që nga viti 1989, për mungesë dijenie të faktit se ishte një ndër përfituesit nga privatizimi i banesave shtetërore apo që meqenëse objekti në Linzë, nuk përbënte banesë – megjithëse sipas tij shërbente si e tillë – përbëjnë mungesë sinqeriteti që nuk duhet të ishte pranuar nga shumica. Kjo qasje e subjektit, duhej të shihej në kompleks me shpjegime të tjera evazive, të pasinqerta e mungesa deklarimi ndër vite, në kontekstin e vlerësimit tërësor. Një analizë e qëndrim i tillë do të ishte në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit³⁵ më herët, kur është arsyetuar që mungesa e njohjes së ligjit nga subjektet e rivlerësimit, sidomos kur flitet për subjekte me përvojë prej disa dekadash në drejtësi, është shpjegim i papranueshëm. Si i tillë, konkluzioni i Komisionit³⁶ se subjekti mund të përfitonte vetëm në kufirin prej 2,5 milionë lekësh kredi lehtësuese, për shkak të parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102/1999 në pikat 2 dhe 6³⁷, duke përfituar vetëm *shtesë banimi*, është i drejtë dhe duhet të ishte analizuar në tërësinë e veprimeve të subjektit. Këto të fundit kanë përbërë zgjedhje të tij ndër vite për krijimin e pasurive objekt kontrolli në procesin e rivlerësimit, bazuar në veprime minimalisht të pasinqerta si në kohën e krijimit, ashtu edhe më pas.

3. Lidhur me pasurinë në Delvinë, në bashkëpronësi të subjektit me prindërit dhe vëllanë, në analizën e vendimit të Komisionit, kundrejt ankimit të subjektit, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e deklarimit të pasaktë sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Konkluzioni i Komisionit edhe për këtë element duhet të ishte pranuar. Subjekti nuk e ka deklaruar ¼ e apartamentit në bashkëpronësi në asnjë moment. Ky fakt duhet të ishte analizuar në harmoni me gjithë elementet e tjera dhe, në funksion të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, të vlerësohej minimalisht si pasaktësi në deklarim dhe të ishte pjesë përbërëse e vlerësimit tërësor, të kryer në bazë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me shkaqet e tjera të shtjelluara këtu.

3.1. Nga aktet në fashikuj, rezulton që subjekti pretendon se nuk ka qenë në dijeni deri në vitin 2011, se sipas ligjit nr. 7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” – si të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë që me hyrjen në fuqi të këtij ligji kishin mbushur moshën 18 vjeç [23.12.1992, hyrë në fuqi më 22.01.1993] – përfitonte një pjesë takuese të apartamentit ku ka

³⁵ Shih paragrafin 27.12.16 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj [JR nr. 11/2019] dhe 19.4.iv të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Peka [JR nr. 27/2020].

³⁶ Shih faqen 34 të vendimit.

³⁷ <http://www.ikub.al/LIGJE/903050040/Article-Per-trajtimin-me-strehim-te-funksionareve-politike-dhe-nepunesve-civile-te-Administrates-se-Larte-Shteterore-.aspx?cookiesEnabled=false>

jetuar me prindërit deri në vitin 1985³⁸. Nga ana tjetër, në saje të të njëjtit ligj, në vitin 2000 subjekti pranon se ka privatizuar një pjesë pasurie të paluajtshme, ish-pronë publike në një qytet ku nuk banonte prej vitesh [shtjelluar më sipër në paragrafin 2.6.] – në shkelje të hapur të kriterëve të ligjit. Në dritën e këtyre kontradiktave, si dhe pretendimit të tij për mungesë dijenie, shpjegimet e subjektit se deri në vitin 2011 nuk ishte në dijeni se në vitin 1993 kishte hyrë në fuqi një ligj nga i cili ai përfitonte të drejta pasurore, apo që ka vijuar me deklaratën noteriale për të hequr dorë sa e mësoi atë fakt, janë qesharake. Si i tillë, edhe ky pretendim duhej të vlerësohej nga shumica në kontekstin e vetëm logjik, atë të mungesës së sinqeritetit të subjektit gjatë gjithë procesit. Në analizë të kronologjisë kohore dhe të faktit që deklarata noteriale për heqjen dorë në fakt nuk ka passjellë *asnjë* pasojë juridike sipas përcaktimeve të nenit 191 të Kodit Civil³⁹, përderisa nuk është regjistruar, shpjegimet dhe veprimet e subjektit duhet të ishin vlerësuar në kontekstin e procesit të rivlerësimit dhe të shoqëroheshin [minimalisht] me konstatimin e pasaktësisë në deklaram sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

3.2. Përpos sa më sipër, qëndrimi i shumicës bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit në raste të tjera të ngjashme, kur trupi gjykues është shprehur qartë në këtë drejtim për pasaktësi dhe deklaram të pamjaftueshëm, përfshirë edhe kur pasaktësia ishte veprim i personit të lidhur apo, si në rastin e parë [të cituar më poshtë], edhe në kushtet e mungesës së konstatimit nga Komisioni të deklaramit të pasaktë, Kolegji ka arsyetuar që:

“[...] znj. E. B. gëzon ende të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme tokë bujqësore, truall dhe ndërtesë në fshatin {***}, Devoll, për rrjedhojë Komisioni duhet ta kishte konstatuar dhe analizuar këtë fakt, duke vlerësuar se ajo duhet t’i kishte deklaruar këto pasuri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [...]”.

“[...] trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurisë së paluajtshme të bashkëshortes as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në deklaratat e pasurisë në vite, e vendos subjektin në kushtet e deklaramit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 [...]”⁴⁰.

“[...] Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit B. M., nuk ka deklaruar pasuritë e saj në bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklaramin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur për “burimin” në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këto

³⁸ Sipas shpjegimeve për rezultatet e hetimit, datë 28.02.2019, faqe 11.

³⁹ Neni 191, paragrafi i dytë i Kodit Civil parashikon: “[...] Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet”.

⁴⁰ Paragrafët 40 dhe 41 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Belishta [JR nr. 1/2020].

rrethana faktike, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Kolegji këtë pasaktësi, nëse do ishte e vetme në deklaramin e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se nuk do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin tërësor të procedurave, aplikimi i nenit 61, paragrafi 5 i ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim si pasojë e kësaj ndërvarjeje midis rrethanave faktike dhe ligjore të konstatuara si gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në vlerësimin tërësor për qëllim të procesit të rivlerësimit [...]⁴¹.

3.3. Së fundmi, konstatimet e shumicës sa i përket kësaj pasurie – konkretisht, heqja dorë nga pronësia mbi pjesën takuese “në favor të nënës”, sa i përket apartamentit në Delvinë nga subjekti i rivlerësimit vetëm në vitin 2011, duhet të ishin analizuar në kontekstin e besueshmërisë së pretendimeve të subjektit, apo veprimeve të tjera të subjektit me natyrë fitim pronësie, përfshirë edhe ato të kryera në të njëjtën kohë – gusht 2011. Konkretisht, njëherësh me deklaratën noteriale për heqje dorë nga apartamenti në Delvinë, subjekti ka ndërmarrë veprime drejt fitimit të pronësisë së një ndërtimi të paligjshëm disakatësh në Lukovë, bashkë me familjarët e tij. Prej 3 vjetësh ky ndërtim përbente vepër penale, sipas ndryshimeve të passjella nga neni 199/a⁴² i Kodit Penal. Duke parë të dyja këto grupe veprimesh dhe mangësitë e hetimit të kryer nga Komisioni në funksion të konstatimit nëse ky ndërtim i atribuohet vetë subjektit – siç rezulton nga deklarimi i babait të subjektit⁴³ – është alogjike të konstatosh që subjekti ishte në gjendje *mungese vëmendjeje*, siç ka konstatuar shumica. Subjekti realisht ndërmerrte veprimet fundore drejt legalizimit të një ndërtimi të paligjshëm me vlerë të konsiderueshme⁴⁴ që, sipas deklaratës noteriale të kryer nga i ati në të njëjtën kohë që subjekti hiqte dorë nga apartamenti në Delvinë, ishte investim *i vetë subjektit*. Këto veprime të kryera prej tij [subjektit të rivlerësimit], në kushtet kur flitet për një ndërtim të paligjshëm – më pas një vepër penale – më pas të legalizuar dhe potencialisht të atribuuar një prokurori në pozicione me rëndësi, duhet të ishin parë nga shumica minimalisht në kontekstin e cenimit të besimit të publikut në formën e përfitimeve për shkak të detyrës⁴⁵. Kjo analizë ishte e domosdoshme sidomos në kushtet kur, nga kontrolli i

⁴¹ Shih paragrafët 77 dhe 78 të vendimit të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi [JR nr. 32/2019].

⁴² Neni 199/a parashikon: “[...] Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasojë të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet”.

⁴³ Deklaratë noteriale e z. P. K., lëshuar më 01.08.2011 [nr. {***} rep., {***} kol.] përpara noterit Th. T. K., Sarandë.

⁴⁴ Sipas vetëdeklarimit për legalizim, përbërë nga 500 m² truall dhe 332 m² sipërfaqe banimi, ndarë në tri kate, në një vendndodhje bregdetare dhe me vlerë investimi 14.971.164 lekë sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime informale, lëshuar nga ALUIZNI në vitin 2013 [pa datë].

⁴⁵ Shih parimet e Bangalores, për detyrimet e gjyqtarëve që gjejnë zbatim për shkak të natyrës së punës me ato të prokurorëve. Sipas paragrafit 44, përfitimi nga funksioni zyrtar për qëllime personale përbën shpërdorim të detyrës. Ky koncept është materializuar tanimë në ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, ndër të tjera në nenin 103, germa “b” dhe “d”, ndërsa sipas nenit 3, pika 5 përcaktohet në kontekstin e detyrimeve ndaj ruajtjes së besimit të publikut të drejtësia.

pasurisë, rezulton se pasuria në Lukovë nuk është i vetmi ndërtim i paligjshëm me të cilin asociohet subjekti i rivlerësimit ndër vite apo që ka shërbyer për të krijuar pasuri të konsiderueshme nga ana e tij [shih edhe paragrafët 2.5 dhe 2.9], apo i vetmi transaksion me elemente paligjshmërie [shih paragrafët 2.7. - 2.9. më sipër].

4. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ndër vite ka pasur 9 (nëntë) pasuri të paluajtshme, me vlera të konsiderueshme, katër prej të cilave janë shitur në vitet 2009, 2010, 2015 dhe 2018. Subjekti i rivlerësimit i ka pasur këto pasuri në posedim që në vitin 2009⁴⁶, ndërsa regjistrimi është kryer në vitin 2014. Në kundërshtim me detyrimet e tij sipas nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këto pasuri të paluajtshme që nga momenti i përfitimit të tyre [2009] e deri në vitin 2013. Nga ana tjetër, në deklaratat periodike vjetore për vitet 2009 dhe 2010, subjekti ka zgjedhur të deklarojë të ardhurat nga shitja e dy pasurive, në funksion të justifikimit të burimeve të financimit për pasuri të tjera të tij në Lukovë e Voskopojë. Këto rrethana faktike kanë qenë pjesë e vlerësimit të kriterit tërësor të çështjes, në drejtim të masës disiplinore të shkarkimit.

4.1. Në këto rrethana faktike, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk janë deklaruar pasuritë pasi nuk ka qenë *de jure pronar i tyre*, bie ndesh me logjikën dhe me detyrimet e tij si subjekt deklarues në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003⁴⁷ dhe përbën një element që shumica duhet ta kishte konsideruar në kontekstin e mungesës së *përsëritur* të sinqeritetit nga subjekti ndër vite, por edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Pikërisht për të rregulluar situatat në të cilat subjektet deklaruese sipas ligjit nr. 9049/2003, për arsye të ndryshme nuk janë pronarë *de jure* të pasurive, ligjvënësi ka përfshirë edhe detyrimin për deklarim pasurive të regjistruara ose jo në regjistrat publikë dhe të *të drejtave reale*. Nëse do të ndiqej logjika e subjektit apo e shumicës në këtë interpretim, kjo kërkesë e shprehur e ligjit do të ishte pa peshë dhe e tepërt. Nën dritën e faktit që subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e pasurive dhe, si rrjedhojë, është i pakontestueshëm gëzimi i të drejtave reale mbi to, qëndrimi i shumicës [shih paragrafët 26 dhe 27], mbështetur vetëm në faktin që mbi këto prona nuk kishte “[...] hipotekë, servitut, e drejtë përdorimi/banimi, uzurfrukti apo enfiteoze [...]”, përbën një arsyetim të pakuptimtë që bie ndesh me faktet: subjekti ka vepruar si pronar, ka pranuar se ka marrë çelësat në dorë në vitin 2009, për 9 (nëntë) pasuri të paluajtshme [5 apartamente, të tjerat njësi shërbimi e garazhe, konfirmuar edhe nga kontratat e energjisë elektrike të hapura më 25.03.2009 dhe, mbi të gjitha, ka përfituar të ardhura nga shitja të cilat i ka deklaruar pasi kishte kryer investime, për të cilat duhet të deklaronte burimin ndër vite, si subjekt deklarues i ligjit nr. 9049/2003.

⁴⁶ Shih faqen 7 të vendimit të Komisionit.

⁴⁷ Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 përcakton: “[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë [...] si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]. Udhëzimi në krye të faqes 3 të formularit rekomandon: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) [...] të çdo lloji pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë [...]”.

4.2. Për sa më sipër, votuam për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe vlerësimin e kësaj rrethane si pjesë e vlerësimit tërësor. Pavarësisht nga mangësitë e konstatuara në hetimin e kryer në Komision – në drejtim të ndjekjes së një logjike që bazohej në detaje të mënyrës së përdorimit të apartamenteve që nuk sillnin asnjë vlerë të shtuar për qëllim të rivlerësimit – qëndrimi ynë përputhet edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit⁴⁸ në raste të ngjashme kur janë konstatuar deklarime të pasakta ndër vite apo qasje jokonsistente/selektive nga subjektet e rivlerësimit Në kuadër të vlerësimit tërësor të të gjitha argumenteve, sjellja e subjektit ndër vite, edhe lidhur me këto pasuri, duhet të përbënte minimalisht një ndër elementet që tregonin deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5. Një ndër rrethanat që përbëjnë bazë të konkluzionit përfundimtar të Komisionit lidhet me ndërtimin pa leje nga subjekti i rivlerësimit në Qesarakë dhe mosdeklarimin prej tij në deklaratën për vitin 2003. Objekti ndodhej mbi një sipërfaqe toke prej 830 m², së cilës më pas i ka ndryshuar destinacionin në tokë truall [shih edhe arsyetimin më sipër në paragrafët 2.5. dhe 2.9.]. Si edhe Komisioni, vërejmë që ashtu si edhe për pasuri të tjera, të shtjelluara më sipër, subjekti ka deklaruar *vetëm të ardhurat* e përfituara nga objekti i ndërtuar pa leje, në formën e qirasë në vlerën 15.000 lekë në muaj, nga shoqëria ndërtuese, për periudhën 2006-2007-2008⁴⁹. Kjo pasuri ka shërbyer si zanafillë e 9 (nëntë) pasurive të tjera, katër prej të cilave janë shitur (shtjelluar më sipër në paragrafët 4, 4.1 dhe 4.2). Me fjalë të tjera, subjekti i rivlerësimit ka përdorur tokën bujqësore në kundërshtim me destinacionin për periudhën 1996 - maj 2000, ka deklaruar vetëm tokën bujqësore në pronësi në vitin 2003 [me deklaratën e parë si subjekt deklarues i ligjit nr. 9049/2003] dhe asnjëherë objektin shtëpi banimi ndërtuar mbi të, të cilin është përpjekur ta legalizojë. Më konkretisht, në vitin 2005 subjekti ka bërë vetëdeklarim për legalizim të objektit shtëpi banimi me sipërfaqe 36 m² dhe ka specifikuar se vetëdeklarimi ka për qëllim kthimin e tokës arë në truall. Nga aktet në fashikull, rezulton se ndërtimin në këtë tokë arë e ka kryer subjekti⁵⁰.

5.1. Nga aktet në fashikull, rezulton qasje selektive e subjektit edhe për sa i përket një sërë transaksionesh të tjera, të kryera prej tij përpara vitit 2009, që rrjedhin nga kjo pasuri.

⁴⁸ Shih vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Altina Xhoxhaj [JR nr. 9/2018] paragrafi 42, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori [JR nr. 19/2019], paragrafin 22.11 dhe me referim në çështjet që i përkasin subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama [JR nr. 5/2019] paragrafët 23-26, subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari [JR nr. 6/2019] paragrafi 21.20, subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli [JR nr. 9/2019], paragrafët 10.1.5 dhe 12.2, subjektit Bledar Abdullai [JR nr. 13/2019], paragrafi 86.

⁴⁹Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi dhënien e tokës bujqësore “[...] për ndërtimin e një objekti banimi shumëkatësh, sipërfaqja e tokës bujqësore 830 m² [...]. Në rubrikën “Të dhëna që nuk publikohen” të deklaratës së mësipërme, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “[...] sipas kontratë shkëmbimi (me kusht) nr. {***}, datë 16.09.2005, (pika 7.10), firma “{***}” ShPK i ka paguar që nga marsi i vitit 2006 (data e fillimit të punimeve) qira në masën 15.000 lekë në muaj për shfrytëzimin e tokës dhe prishjen e një barake që përdorej prej meje [...]”.

⁵⁰ Sipas procesverbalit të pyetjes së shitësit F. A., pyetur gjatë hetimit administrativ në Komision, më datë 07.02.2019, në tokën arë nuk ka pasur ndërtime derisa subjekti ka ndërtuar godinën në fjalë.

Konkretisht, subjekti nuk ka deklaruar as kontratën e shkëmbimit⁵¹ [me kusht] me ndërtuesin e pasurive të paluajtshme (detajuar në paragrafin 4 dhe nënndarjet e tij) në deklaratën periodike vjetore përkatëse [për vitin 2005], dhe as Aneksin e saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007. Sipas këtij të fundit, ai përfitonte 26% të sipërfaqes së ndërtimit, që vlerësohej të ishte të paktën 700 m². Votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit edhe sa i përket peshës së këtyre rrethanave faktike në vlerësimin përfundimtar, pasi parë në harmoni me aktet në fashikull dhe arsyetimin e bërë më sipër, edhe në këtë element, rezulton se subjekti ka zgjedhur të deklarojë të ardhurat, por jo zanafillën e pasurive dhe, për pasojë, ka anashkaluar mënyrën se si janë krijuar pasuritë, në momentin kur janë krijuar. Ky përfundim është përpos sa është shtjelluar më sipër, e konkretisht faktit që në momentin kur ka përfituar kredinë në kushte lehtësuese apo përfituar nga privatizimi në Korçë si i pastrehë, subjekti posedonte këtë godinë dhe tokën mbi të cilën ajo ndodhej.

5.2. Konkluzioni i shumicës, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se objekti nuk kishte themele e për pasojë nuk i nënshtrohej deklaramit, bie ndesh me udhëzimet e formularit të deklaramit sipas ligjit nr. 9049/2003 edhe në variantin që ka qenë në fuqi në mars 2004, kur subjekti ka kryer deklaramin e parë, sipas të cilit subjektet duhet të deklarojnë “toka [...] ndërtesat (dyqane, shtëpi banimi, magazina etj. [...]).” Së dyti, pretendimi i subjektit bie ndesh edhe me konceptin e vetëdeklaramit sipas ligjit nr. 9304/2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, sipas të cilit ai pranon se ka kryer deklaramin e parë më 17.03.2005 apo me ligjet e tjera që kanë zëvendësuar ligjin fillestar për sa i përket objektit të ligjit dhe fushës së zbatimit. Neni 2 i ligjit i ndante objektet në tri grupe: banesa, ndërtime me funksion arsimor dhe shëndetësor dhe ndërtimet e veçanta pa leje “[...] kur janë në përputhje me studimin e miratuar të zonës përkatëse dhe plotësojnë kushtet [...] e ligjit nr. 8405/1998 “Për urbanistikën” [...]”. Dukshëm, vetëdeklarami i subjektit për objektin ka qenë si banesë, pasi nuk mund të argumentohet se bën pjesë në grupin e institucioneve arsimore apo shëndetësore, apo të jetë kryer në përputhje me kushtet e ligjit nr. 8405/1998 – nëse mbahen në konsideratë pretendimet e tij se ishte një banesë në kushte të papërshtatshme banimi apo “me blloqe betoni” apo “provizore”.

5.3. Nga aktet në fashikull, rezulton se konkluzioni i Komisionit për paqartësi të akteve të pronësisë së tokës – për shkak të korrigjimeve të shumta – në momentin kur është kryer ndërtimi dhe janë bërë pagesat fillestare nga subjekti, duhet të ishin pjesë e analizës tërësore nga trupi gjykues i Kolegjit i të gjitha rrethanave që përbëjnë mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, së bashku me faktin e pakontestueshëm se ndërtimi është bërë pa leje dhe nuk është deklaruar nga subjekti as në vitin 2003 dhe as më pas. Komisioni ka theksuar faktin që Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) për këtë tokë bujqësore, ka qenë me plot parregullsi, korrigjime mbi emrin e përfituesit, mospërputhje në sipërfaqet e deklaruara apo në emrat e pronarëve kufitarë brenda të njëjtit akt, dhe marrëveshja verbale mes subjektit dhe z. F. A. në vitin 1996 nuk

⁵¹ Kontratë shkëmbimi (me kusht) nr. {***}, datë 16.09.2005, apo dhe Aneksi i saj, datë 20.06.2007. Sipas këtij të fundit, subjekti i rivlerësimit ka përfituar sipërfaqe banimi gjithsej 657,70 m², sipërfaqe dyqanesh gjithsej 108,30 m², sipërfaqe garazhe gjithsej 162,50 m², parking total sipërfaqja 162,5 m².

legjitimonte investimin nga subjekti mbi sipërfaqen prej 830 m². Vetë subjekti është kontradiktor: duke pranuar nga njëra anë që objekti i shërbente për banim, megjithëse ishte provizor dhe i papërshtatshëm, dhe nga ana tjetër që për qëllim të vetëm kishte kthimin në truall. I pyetur në Komision, më datë 07.02.2019, shitësi F. A., ndër të tjera, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ishte në kufi me vëllain e tij I. A. Në AMTP-në e vitit 1992, nuk rezulton një fakt i tillë. Nga ana tjetër, vetë Komisioni rezulton të mos ketë prodhuar analizë financiare përfundimtare për gjithë vitet [përveç asaj që lidhet me rezultatet e hetimit administrativ], për të vlerësuar pasaktësitë ndër vite të konstatuara në hetim apo mundësinë e kryerjes së pagesave me burime të ligjshme në momentin kur ato janë kryer⁵² apo mënyrën se si pagesat janë kryer. Për herë të parë, këtë objekt subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar gjatë hetimit administrativ. Deklarimi i të ardhurave nga qiraja për vitet 2006, 2007 dhe 2008, përfituar nga shoqëria “{***}” ShPK, në masën 15.000 lekë në muaj, nuk mund të konsiderohet se zhbën mosdeklarimin në deklaratën e vitit 2003 të banesës së ndërtuar në tokën arë me sipërfaqe 830 m², ndodhur në Linzë, Tiranë, të përdorur nga subjekti si banesë. Duke lënë mënjanë mangësitë në hetimin e Komisionit për sa i përket aftësisë paguese me burime të ligjshme të subjektit në momentin e pagesës, analiza e deklarimeve të subjektit ndër vite dhe në procesin e rivlerësimit konfirmon bindjen që vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi. Në kuadër të vlerësimit tërësor, edhe ky element i qasjes së subjektit, ndër vite dhe gjatë procesit të rivlerësimit, në funksion të transparencës për mënyrën e krijimit të pasurive apo deklarimit të tyre në momentin e krijimit, përveçse përbëhet nga veprime që vështirësojnë kontrollin e pasurisë së tij, duhet parë edhe në vlerësimin tërësor në kuadër të besimit të publikut të drejtësia. Ky qëndrim është në përputhje edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit⁵³, ku shkarkimi është bazuar edhe në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për rrethana që lidhen me mënyrën se si subjektet kanë zgjedhur të deklarojnë pasuritë apo sinqeritetin e treguar ndër vite dhe në procesin e rivlerësimit, në kontekstin e detyrimit kushtetues sipas Nenit D, pika 5 që parashikon prezumimin për shkarkim nga detyra në rastet kur vërtetohen rrethana në të cilat subjektet përpiqen të paraqesin në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim.

6. Për sa më sipër, arritëm në këtë konkluzion pasi konstatoam se në pasuritë e asociuara me subjektin ndër vite, ka probleme të theksuara në deklaram apo vija ndarëse e ligjshmërisë bëhet e paqartë. Ky qëndrim i yni bazohet edhe në përcaktimin e pikës 2 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit arritja e nivelit të përshtatshmërisë në të tria kriteret nuk ka përparësi kundrejt ekzistencës së rrethanave që asociohen me pritshmëri për cenim të besimit të publikut. Pretendimi i subjektit, i pranuar nga shumica, se sjelljet e tij nuk kanë përbërë shkelje të kodeve të etikës ndër vite apo që standardet ndërkombëtare⁵⁴ janë bërë pjesë e rregullave në vitet 2000-2005, që nënkupton vite pasi subjekti ka ndërmarrë disa nga veprimet që në vlerësimin tonë janë të papranueshme për një magjistrat, është po ashtu alogjik, parë në kontekstin e vlerave të sjelljes

⁵² Nga aktet në fashikull, rezulton se për të analizuar mundësinë financiare për pagesën e tokës në maj 2000, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e gjithë vitit 2000 për subjektin.

⁵³ Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani [JR nr. 2/2020], paragrafët 24.5. dhe 25.3 dhe vendimin e Kolegjit që i përket ankimit të subjektit Ervin Metalla [JR nr. 28/2019].

⁵⁴ Referuar konkretisht Parimeve të Bangalores dhe Udhëzuesit Evropian mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë (“The Budapest Guidelines”), shih paragrafin 78 të arsyesimit të shumicës.

dhe integritetit të subjektit në raport me respektin për ligjin përgjithësisht. Sjellim në vëmendje se së pari, duke filluar nga ndryshimet ligjore të vitit 1995 [me ligjin nr. 7919/1995], ligjvënësi ka parashikuar pasoja deri në largim nga detyra për sjelljen e papërshtatshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sanksionuar më pas në ligjin nr. 8737/2001, në kontekstin e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit. Shkelja e ligjeve apo veprimi në kufijtë e ligjshmërisë, pavarësisht nga mungesa e denoncimeve nga publiku – një standard që gjithsesi përmban elemente subjektiviteti të skajshëm – përbën në vlerësimin tonë një rast tipik të sjelljes së papërshtatshme të një prokurori, qoftë edhe në kontekstin e formulimit ligjor të vitit 1995.

7. Për sa më sipër, duke vlerësuar në kompleks pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe rrethanat të cilat i cilësojmë se përbëjnë elemente të cenimit të besimit të publikut, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit Arqilea Koça nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë.

Gjyqtare

Natasha MULAJ

nënshkrimi

Gjyqtare

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi